



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KATËRT TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 27.04.2023 (e enjte) në shtëpinë e kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës) si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Marigona Avdiu, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, zn.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emimi, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Musli Neziri, z.Veton Ramadani, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, znj.Anisë Zejnullahu, z.Sokol Hyseni, z.Reshat Azizi, z.Illir Zuka, ndërsa mungoi, z.Sokol Shaqiri, z.Taulant Haxhiu, Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë. Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, materialin e keni marrë me kohë. Gjatë kësaj periudhe nga senca e kaluar disa akte na u kan kthy, disa jo prej ministrisë ende. Pjesa e caktimit të lokacionit për objektin për persona me aftësi të kufizuar na është kthyer si jo në rregull, për shkak që nuk është në planin urbanistik. Ajo na është kthy për rishqyrtim, që në seancën e ardhshme do të vie. Pjesa tjetër çka na është kthy jemi në rregull, por janë edhe disa që nuk kanë ardhë po na u vonohen. Para se të hy në rend të ditës, vazhdojmë me pyetje, përgjigje me nga 2 pyetje.

znj.Valentina Mehmeti: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam një kërkesë dhe një pyetje. Kërkesa më ka ardhë nga familja Zeqiri dhe disa banorë të tjerë që jetojnë në atë lagje nga fshati Budrikë e Epërme, për një problem që kanë me kanalizim, ku thuhet se, që nga instalimi i rrjetit të kanalizimit para 8-9 viteve në fshatin Budrikë e Epërme është bërë një lëshim teknik, nga i cili po e vuan më së shumti familja Zeqiri, sepse gypat të cilët janë vendosur për përcjelljen e kanalizimit si dhe pusetat nuk janë vendosur në mënyrë profesionale, duke vendosur mbi nivelin e tokës dhe më pas janë mbuluar me dhe, gjë që kjo e ka bërë të pamundur për të përfutur një ramje sa më të lirë dhe që nuk është llogaritur me kohë. Pas çdo shiu të rrëmbyeshëm ujrave të zeza nga kanalizimi kthehen mbrapsht, ku futen në oborr dhe në shtëpitë e tyre. Sipas familjës, komuna është njoftuar, por nuk ka pas ndonjë përgjigje, andaj kërkoj që ky problem të zgjidhet sa më shpejtë. Pyetje tjetër është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, rreth ujësjellësit, meqenëse shumica e fshatrave që e kanë të rregulluar ujësjellësin, fshati Budrikë është një ndër fshatrat që ka nevojë për rregullimin e ujësjellësit, pasi që, siç dihet se gjysma e fshatit, nuk e perdorin ujin, sepse uji nuk është i pijshëm, gjë që

është një ndër nevojat jetësore dhe primare për njeriun. Pyetja është se kur do të funksionalizohet ujësjellësi në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtë në ujë të pijshëm.

z.Ilir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Po vazhdoj unë me atë avazin prej fillimit të mandatit e deri më sot, problemi i shkollës së Pozheranit. E di që nënkryetari këto ditë ka pas disa takime në ministri, edhe në ministri të arsimit, por sipas informacioneve që kam, ka pas edhe në OSHP dhe me siguri na jep një spjegim çka është ka ndodhë me të. Kisha pas dëshirë që me të njëjten me lidhë edhe problemin e stadiumit që e dimë e kam ngritë edhe në KPF, veç me na dhanë një spejgim, se sipas informacioneve që kam unë për këtë vit nuk është parapa asnjë euro për stadiumin e “Vllaznisë” së Pozheranit, si dhe kryesues kisha pas dëshirë nga Drejtoria e Inspeksionit, sot kam pas një ankesë nga qytetarët prej qenve endacak.

z.Jakup Demiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam dy pyetje për komunën njëra ka të bëjë me dy projektet që janë duke u punuar në fshatin Smirë, njëra është një rrugë që është mbi vorreza të fshatit, lidhet me një rrugë malore, por që ka bë shumë dëme në rrugën ekzistuese, domethanë e ka shkatrru komplet rrugën tjetër, që një pjesë ka qenë e kryer si projekt nga vetë komuniteti i fshatit aty dhe një pjesë tjetër është që ende 3 vite nuk i ka ajo pjesë e rrugës që është kry nga komuna është asfaltu, por të cilat nga punimet tashti që janë bërë mbi fshatë është shkatrruar thuajse e gjithë rruga. Neve si fshat kjo na ka shqetsu për shkak se një rrugë që është aq e nevojshme për vorreza shkatrohet në atë masë, duke e bërë një punë për një rrugë tjetër, një projekt që nuk është ku me ditë sa i rëndësishëm, dhe nuk ka qenë fare hiq prioritet i fshatit ajo. Se ka e ka marrë komuna atë ide për me bë atë nuk e di, dhe kisha ftu që të dilni dhe t’i shikoni vetë. Dhe pjesa tjetër po në Smirë është trotuari në lagjen, në rrugën “Metush Ibrahim”, e cila gjatë realizimit edhe aty është dëmtu rruga. Ka kërkesë nga këshilli i fshatit që të dilet dhe të shikohet nga komuna dhe të vlerësohet dami. Ne kemi mbajtë takim me këshillin e fshatit, dhe unë po e bëjë atë kërkesë. Pyetja e dytë lidhet me një intervenim që është bërë në muajin e kaluar afër vorrezave të Vitisë, afër Kabashit, që pas intervenimit nuk është realizuar apo sanuar gjendja si duhet, dhe pjesa më e madhe e dheut aty është në rrugën kryesore. Para kësaj mbledhje nuk e kam paraqitë këtë problematikë, se ka qenë 1 javë apo 10 ditë para mbledhjes dhe kam mendu që kanë me i vazhdu punimet apo do të rregullohet kjo gjendje është edhe sot fotografia, është e djeshit. Kisha pas dëshirë që edhe aty të intervenohet, ndërsa për projektin në Smirë mundeni me pa edhe në foto. Kjo është thuaj se fillim e mbarim në këtë gjendje, është dëmtuar e gjithë rruga, por për mos me shfaq foto, mos me bë filma, ju kisha ftu që ta shiqoni vet atje dhe ta vlerësoni gjendjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pjesa që e përmendi edhe z.Jakupi është me të vërtet dëmtimi jashtëzakonisht i madh i asfaltit që është deri te varrezat, për shkak të peshave të rënda të zallit që është bartë për tu bërë rregullimi i rrugës naltë. Unë e konfirmoj atë pjesë, se kam qenë e kam shiku. Drejtor i shërbimeve publike, kisha pas një kërkesë që, nëse ka mundësi që kjo pjesa nalt mbi neve brenda kuvendit komunal nuk ta lejon mi mbajtë seancat për shkak që dielli i fortë dhe pengon gjatë seancës. Besoj që kjo bjen në drejtorinë e juve.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Kryesues, kjo çështje mundet me u kry përmes kuvendit. Ti e ke një kod, shërbime dhe mallra, dhe ki të drejtë me e kontraktu një kompani e cila ta kryen këtë shërbim. Po e themë këtë se jam kanë në ngjarje kur ka kërku në atë kohë ish kryesuesi Naimi, por megjithatë nuk kishte mjete. Shikoje, në rastë se ke mjete e kontakton një kompani, kontaktojmë me Zyren e Prokurorimit, mbajmë një takim të përbashkët e shikojmë aspektin financiar si e kemi gjendjen, nëse nuk ka buxhet. Në rast se nuk ke atëhere duhet me kërku një kodë tjetër.

z.Basri Sylejmani:Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë kisha pas dy pyetje, rruga, trotuari Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e Muhaxherve, për drejtorin ose nënkryetarin dhe në Goshicë është prej autobusit ku është parku përpara deri në bilidup e kan bë deponi krejt bërlllog është.

z.Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam një pyetje edhe pse kjo pyetje po përseritet gati se në secilën seancë rreth trotuarit dhe ndriçimit publik gati në secilën seancë deri më tani e kam ngritë

çështjen e trotuarit, e cila i lidh 3 fshatrat, Sodovinë e Muhaxherve, Trestenikin dhe Sllatinën e Eperme dhe ndriçimi publik në Sodovinë të muhaxhereve dhe në disa lagje të fshatit Trestenikë, mirëpo deri më tani nuk kemi diçka konkrete rreth kësaj çështje, pyetja ime është, kur do të filloj implementimi i këtyre projekteve. Ne e dimë që këto projekte janë të inkorporuara në kontrata të cilat janë të lidhura. Mendoj që këto projekte janë vitale për banorët e këtyre fshatrave. Pyetja e dytë, rruga Viti-Kërbliq. Ky projekt është i financuar prej ministrisë, mirëpo procedurat e prokurimit i ka udhëhequr Komuna e Vitisë. Deri më tani ne si këshilltarë komunal nuk e dimë fazën e implementimit të këtij projekti deri ku kanë arritë implementimi i punëve të këtij projekti, a janë në fazën fillestare, fazën e mesme, fazën përfundimtare. Kërkojmë nga ju si strukturë udhëheqese, por edhe prej menaxherit të projektit, të bëni një raport, ta dimë procedura ku është.

z.Zyrafete Rama: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Jemi dëshmitarë që uji i pijshëm paraqet një problem tejet të madh për qytetin e Vitisë dhe fshatrat e saj, edhe pse e dimë që në shumë lokalitete është i shtrirë rrjeti, mirëpo ujë nuk ka, andaj i nderuar nënkryetar, a mund të na informoni se a ka Komuna e Vitisë një plan konkret për funksionalizimin e këtyre rrjeteve dhe për sigurimin e ujësellsit për sigurimin e ujit të pijshëm për gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Arbnora Hajredini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Më vjen mirë prej Drejtorisë së Arsimit që e ka bërë një lëvizje për studenta, për mirëqenien e tyre, por sa është me shpresë diplomimi i tyre kur Zyra e Personelit përcakton renditjen për punësim, kur i jepet atyre shanca me hy në listë, sepse notat e profesorëve universitar nuk kanë më shumë vlerë se sa vlerësimi i Hysen Ymerit.

z.Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam dy pyetje, meqense në mungesë të drejtoreshës së arsimit, njëren pyetje po e terheku, po e shtoj një tjetër për drejtorin tjetër. Pyetja e parë ka të bëjë me paraqitjen ose publikimin e listave për bursat e studentëve. Javën e kaluar është publiku lista dhe është mirë që janë përkrah gjithë këta studentë, por në kuadër të kësaj ne kemi marrë disa ankesa dhe ankesa ka të bëjë me studentët të cilët janë bursistë nga universitetet e ndryshme shtetërore, por që nuk janë përfshi në këtë listë dhe në konkursin që ka qenë publik nuk ka pas ndonjë kriter që me i përjashtu këta studentë. Pjesa tjetër, ne duhet të jemi krenarë që kemi studentë bursistë që janë dhe që duhet përkrahen. Zaten unë mendoj që ata të cilët janë bursistë nga universiteti duhet të jenë të parët që duhet t'i prinë listës, burses komunale, për arsye se buxheti nga komuna dhe buxhetet e bursave universitare nuk janë të përbashkta asgjë dhe a është përfill tek të gjithë kjo apo mos ndonjë eventualisht është bërë ndonjë lëshim, sepse mendoj që duhet të ketë kujdes aty, ata duhet të përkrahen. Ne si komunë të lutemi që të kemi studentë të tillë. Pyetja e dytë ka të bëjë me fushatën e pastertisë që e kemi pas gjatë muajit prill. Po du të pyes se sa janë kry aktivitetet e asaj. Domethanë se sa deponi ilegale janë evituar ose eliminuar dhe a do të vazhdohet kjo iniciativë, sepse edhe vitin e kaluar e kam pas një kërkesë për drejtorin e urbanizmit dhe planifikimit hapsinorë, kryesisht që është një deponi ilegale në mes fshatrave Terpezë dhe Ballancë, dhe aty ende nuk është marrë diçka, prandaj po dua të pyes a do të largohet kjo deponi, domethanë edhe vitin e kaluar e kam pas të njëjtën kërkesë ndaj Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit hapësinorë, besoj këtu përgjigjet drejtori Visar Demiri. Faleminderit!

znj.Liridona Bislimi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket pyetjeve dhe kërkesat nga qytetarët, unë dua të fillojë me problematiken me mungesën e ndriçimit publik te rruga “Rrust Sadiku” në fshatin Skifteraj. Realisht unë këtë problematikë, këtë shqetësim e kam pranuar më herët, mirëpo kam mendu që ka problem me ndriçim publik dhe kam diskutu me drejtorin e shërbimeve publike, dhe kështu ja kam adresu pyetjen, ndërsa së fundi kuptova që nuk ka fare ndriçim në këtë rrugë. Kjo është shqetësuese nënkryetarë, përkundër faktit që vazhdimisht gjatë seancave publike thirrreni si komuna që ka më së shumti investime në ndriçimin publik, duke marrë parasysh që në këtë rrugë ka shqetësime të mëdha për nxënësit të cilët udhetojnë mbramjeve për në shkollë. Ndërsa tek shqetësimi tjetër, unë dua t'i kërkoj kryetarit Sokol Haliti ta ndryshoj drejtshkrimin ose gabimet drejtshkrimore që po i bënë në postimet e tij. Së fundmi në profilin

personal në facebook, besoj që nuk është etike për një kryetar që është tashmë me mandat të tretë të bëjë gabime gramatikore të rangut të nxënësve të atyre në shkollën fillore, p.sh.: të mos dijë ku ta vendos pikën apo presjen.

zn.Lindita Demelezi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime është se a është menduar paraprakisht për ujrat që po e vërshojnë rrugën e sapo ndertuar Sllatinë – Viti, gjë që po bëhet e pakalueshme gjatë të reshurave për banorët që e frekuentojnë atë pjesë të rrugës, pasi që dihet që ajo është rrugë bujqësore që i dëmton shumë fermer të cilët posedojnë të mbjellura në atë sipërfaqje që gjendet në atë pjesë dhe kur do të ju bëhet kompenzimi pronarve për ato sipërfaqe të tokave që kanë lëshuar me kompenzim.

z.Ali Bajrami: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nuk e di a ta quaj pyetje apo kërkesë, është e drejtuar pikërisht për juve kryesues, ka qenë 3-mujori i 4 i vitit 2021 kur e kam parashtrur si kërkesë që në materialin që na percjellni me naj bashkangjitur edhe materialin prej MAPL-së rreth rregullaritetit të vendimeve, propozim vendimeve dhe rregulloreve që i miratojmë si Kuvend. Deri tash nuk na kanë ardh, besoj që tashti e tutje keni mi bashkëngjitur, nuk është ndonjë ngarkesë, thjeshtë me ditë edhe ne çka është në rregull. Ti po i paraqet, por ti kemi edhe ne me shkrim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht ne sivjet nuk kemi pas. Ato që na u kanë kthyer tashti në seancat që i sjellim në rishqyrtim pikat. Ato ja u bashkëngjesim edhe arsyen që na e ka kthyer ministria pse është ashtu.

z.Ali Bajrami: Faleminderit! Pyetjen e dytë e kam për drejtoreshen e shëndetësisë. Hapsira brenda QKMF-së që është dhanë në shfrytëzim përmes ankandit. Kush është përfitues dhe sa është vlera monetare mujore që pagun përfituesi. Faleminderit!

znj.Majlinda Shabani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë i kam dy çështje. E para ka të bëjë më mungesën e operimit të barnatorëve pas mesnates. Ka qenë një çështje që e kemi diskutuar edhe në Kuvend më herët, megjithatë kemi drejtoreshën. Këtu unë po dua ta pyes se çfarë është ndërmarr për sa i përket këtij shqetësimi dhe çështja dytë kisha dashtë me shtu vëmendjen. Pasi që jam informuar, ka qenë një iniciativë e kolegut asamblast, Taulant Haxhiut, një kërkesë e bizneseve që ditën e diel me qenë ditë pushimi. E di që ndoshta kjo don kohë për sa i përket implementimit, por ndoshta me ngritë si vëmendje dhe si temë që duhet me marrë përbazë kërkesen e tyre, dhe për fund, megjithatë kolegu asamblastë e permendi çështjen e bursave. Përsa i përket përfituesve të bursave, unë kisha dashtë që edhe këtu me bë një vërejtje për sa i përket komisionit që ka bërë vlerësimin, sepse kam pas ankesa në rastin që e permendi kolegu asamblastë. Kam pas familjare që kanë qenë përfituese të bursave universitare dhe në të njëjtën kohë kanë qenë përfituese të bursës komunale, ku pas një dite është telefonu me arsyetimin që është anuluar bursa komunale për shkak që ka qenë përfituese e bursës universitare. Faleminderit!

z.Durim Sylejmani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Gjatë këtij muaji në shkollën e fshatit Sodovinë e Jerlive, në shkollën “28 Nëntori” ka ndodhë një aksident ku si pasojë një nxënëse e shkollës fillore ka pësuar një aksident duke rënë nga shkallët brenda për brenda objektit shkollor. Gjatë asaj dite unë kam parë që mediat lokale kanë tentu me komunikuar me kryetarin e Komunës dhe drejtoreshën e arsimit dhe të njejtë nuk kanë dhanë asnjë prononcim për mediat lokale se çka ka ndodhë atë ditë. Do të doja ta dija pse nuk e kanë bërë këtë, a kanë ndonjë informatë se çka ka ndodhë me atë nxënëse dhe pse vetëm në shkollat e Komunës së Vitisë nxënësit e shkollës fillore nga klasa parë deri në klasën e pestë të mësojnë në katin e parë. Pse nuk mësojnë në katin përdhësë?

z.Remzi Salihu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam një kërkesë për banorët e fshatit Remnikë, të cilët më janë adresuar mua që të ja u besoj juve këtu, pra është fjala për një vend në rrugëkryqin Remnik-Budrikë dhe Skifteraj-Nasal, ku shumë here apo shpeshëhere bëhen aksidente të ndryshme, që fatëbardhësisht deri tani nuk kemi ndonjë fatalitet apo humbje të jetës, por megjithatë dëme materiale ka të konsiderueshme. Rasti i fundit ka ndodhë me 12.04.2023, kështu që, shqetësimi i banorëve të fshatit Remnik

është se a është menduar ndonjëherë për rregullimin e ndonjë rrethrotullimi në atë vend. Jo pse është dëshira apo kërkesë e fshatarve, por vërtetë aty është një vend shumë i rrezikshëm. Tani në mëngjes ka erdha, shumë bukur e vërejtja janë të vendosur tabelat, shenjat e ndalimit, e përparësisë, por megjithatë vetë vendi është asi soji që mund të lajthitet njeriu. Kështu që vetëm një rrethrotullim mund ta zgjidhë këtë problematikë. Si çështje tjetër është deponitë të shumta anembanë Komunës së Vitisë, në të cilën nuk mungojnë edhe në fshatin Remnik dhe adresimi i qytetarëve është ma shumë se që a do të hiqen ato është më shumë se kjo. A do të krijohet një mekanizëm i cili tashti po e futi edhe veten aty, që do të na ndaloj neve që të mos hedhim mbeturina, sepse kur flitet për ndërgjegjësim, kotë, ngase jo që jemi njerzë të pakuptueshëm, por jemi njerzë shumë të lëvërdishëm. Nuk dua thjeshtë ta paguaj shërbimin për heqjen e mbeturinave për 5 euro apo sa është në muaj, dhe bëjë tollovi gjithandej hedhi mbeturinat, po sikur të kishte ndonjë mekanizëm të vetëdijësimit apo vetëdijësimi, ka mbetur vetem te masa e ndëshkimit dhe nëse nuk ka ndëshkim aty, prapë do të vazhdoj një gjë e tillë. Pra, a ka ndonjë iniciativë që të mbikëqyrë apo së paku të jenë në vëzhgim ndonjë vend ku më së shumti hedhin mbeturinat. Ndoshta dikush mund të thotë se kjo ka kosto. Sigurishtë që ka, po nëse marrim një numer të konsiderueshëm të punëtorve që janë me kontratë mbi vepër, shumica prej tyre bëjnë fare pak punë, për mos me thanë aspak. Nga ata njerzë mund të caktohet dikush që ta marrë një rolë të tillë dhe të interesohet për ata njerzë të cilët vend e pavend hedhin mbeturina.

z.Sejdi Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë kam disa kërkesa, njëra ndër to po ndërlihem me kyqjen në autostradë, ku vazhdimisht kemi kërku që Vitia të ketë kyqje në autostradë. Fatmirsisht tanimë edhe zyrtarisht do të bëhet kjo mirëpo pasi që kjo u plotësu linden nevojat tjera për me zhvillu Vitinë. Njëra ndër to e kam potencu edhe më heret, po e ripotencoj në pjesën poshtë ku kufizohemi me zonën e Kaçanikut, në Sodovinë do të ishte e mirëseardhur dhe do të ishte shumë profitabile të bëhet zonë industriale, ku Vitia do të frymon dhe do të zhvillohet krejt ndryshe. Tani ku jemi, kjo duke ja mundësuar kyqjen në autostradë, hekurudha, që është shumë afer aty lidhjet që bëhen me Prishtinë-Shkup-Ferizaj dhe jam mëse i sigurt që Vitia do të dalë nga një zonë qorre, ku me një të ardhme të shkurtë bizneset do të fuqizohen shumë dhe besoj që ka me marrë mbështetjen e të gjithëve ashtu siç e kemi pas edhe kyqjen në autostradë, andaj po bëjë thirrje që kejt bashkarishtë qeveritë qëndrore komunale në Kuvendë t'i bashkojmë forcat dhe të punojmë në këtë drejtim që me të vërtetë të bëjmë diçka të madhe. Pos këtyre punëve të përditshme që i bëjmë të vogla. E dyta, kam një kërkesë nga banorët e ndërtesës të ish NLB, ku edhe vetë kam has në atë gjendje. Pas reshjeve të shiut, oborri i asaj ndërtese që është mbrapa pothuajse është i pakalueshëm për ata banorë të cilët jetojnë aty. Banorët thanë që, më heret është premtu që do të bëhet shtrimi me kubza, mirëpo gjendja qysh ish me të vërtetë me pas në oborrin tonë nuk e kishim toleru, andaj mos ta tolerojmë edhe aty ku jetojnë banorët. Ndrichimi në vendkalimet për këmbësorët e kemi ngritë më herët, shumë mirë që ka fillu me u bë, është kanë kërkesë në Kuvend, pikërisht nga ne, mirëpo edhe shumë vende të tjera të këmbësorëve kanë nevojë me u plotësu me ato që kanë fillu. Nuk e di a është plan me i plotësu edhe tjera, mirëpo mëse e nevojshme është me i bë ato, sepse krijojnë siguri, por edhe bukuri qytetit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më pyetje, me përgjigje së pari ja kisha fillu nga drejtorët, mandej nënkryetari për pyetjet tjera.

z.Adnan Imeri, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Për Drejtorinë e Inspeksionit është parashtrur një pyetje prej z.Illir Zuka, që ka të bëjë me trajtimin e qenve endacak, që është një dukuri mjaftë shqetësuese për të gjithë qytetarët jo vetëm të Komunës së Vitisë, por me sa po e shofë nëpër media edhe në qytetet tjera, mirëpo fati është që në Komunë të Vitisë nuk kemi kafshime, shqetësime, po që është shqetësim që edhe për ne. Drejtorja e Inspeksionit në vitin 2022 ka pas një marrëveshje për trajtimin e qenve endacak, gjë që i ka trajtuar me metoden kastrim, sterelizim, vaksinim dhe lëshim 139 qenë që kanë ndiku jashtëzakonisht. Mirë që të mos ketë sulm në qytetarët, të njëjten punë e kemi vazhdu edhe në vitin 2023, gjë

që i kemi nda gjithësej 17 mijë euro për trajtimin e qenve endacak edhe pse kemi qenë në dijoni që është miratuar dhe ka hyrë në fuqi edhe Strategjia për trajtimin e qenve endacak me dhe pa pronarë, gjë që menaxhohet nga Agjensia e Veterinës dhe Ushqimit, mirëpo nuk kemi qenë të sigurt se kur do të fillojnë ata me trajtimin e qenve dhe ne kemi vazhdu me procedurat e prokurimit dhe e kemi bërë kontratën. Në 3-mujorin e parë të vitit 2023 i kemi trajnuar me metoden siç e ceka më heret 140 dhe gjendja nga inspektori mbikëqyrësi kontratës shihet që është një gjendje e qetë. Kapja e qenve është bërë në qytetin e Vitisë, por edhe nëpër fshatra dhe lokalitete të tjera aty ku e kemi parë që gjendja është më e ndjeshme do të vazhdojmë deri sa të implementohet në mënyrë drejtpërdrejt strategjia nga Agjensia e Veterinës dhe Ushqimit. Në momentin që fillon të implementohet strategjia, atëherë do të jemi në kontakt me ta, t'i informojmë ku të intervenojnë.

z.Besnik Imeri, drejtori: Unë pata disa rrugë që patën vërejtje mi kqyrë dhe një raport që duhet me kërkua për rrugën Viti-Kërbliq.

z.Valmir Sahiti, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Iliri e ngriti shqetësimin rreth çështjes së stadiumit të Pozheranit. Ilir, para 10 dite dhe po ashtu javën e kaluar kemi pas kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Kulturës për 2 projekte që kanë ngecur, ai i palestres sportive në qytetin e Vitisë dhe stadiumit të Pozheranit. Tek palestra sportive momentalisht memorandumimi i bashkëpunimit e di që është në Zyren Ligjore të ministrisë dhe javën e ardhshme besoj që lidhet memorandumimi i ri në mes Ministrisë së Kulturës dhe Komunës së Vitisë zhblllokohet ky proces dhe fillohen me punime në palestrën sportive të Komunës së Vitisë, kurse rreth stadiumit të Pozheranit e kam marrë informatë nga Ministria e Kulturës që për vitin 2023 nuk ka kodë buxhetor dhe mjete të parapara nga Ministria e Kulturës për këtë projekt. Faleminderit!

z.Visar Demiri, drejtori: Përshendetje për të gjithë! Sa i përket pyetjes së Muslisë rreth deponisë mes fshatit Ballacë-Terpezë, këtë vit siç e dini kemi pas ditët e ambientit prej 1 prilli deri me 22 prill, për shkak të kushteve atmosferike nuk kemi mujt me intrevnu nëpër deponi të ndyrshme nëpër territorin e Vitisë dhe e kemi shty këtë aktivitet për më vonë kur rregullohet, që do të ndërlihet dhe me 5 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, ndërkohë do të dalim bashkë me drejtorin e shërbimeve publike do të shohim mundësinë për intevenim.

z.Merrushe Ahmeti, drejtoresha: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ishte kush është operatori ekonomik. Operatori ekonomik është "GALENI pharm", i cili kontratën e ka për 13 vite, ndërsa pagesa mujore është 600 euro në muaj, që në qoftë se e pjestojmë me 12, është mbi 7 mijë euro të ardhura prej këtij operatori ekonomik, ndërsa sa i përket pyetjes tjetër, pse nuk kemi farmaci 24/7 në Viti, është për arsye se bizneset private kanë autonominë e tyre dhe ne si komunë dhe si drejtori nuk kemi kompetencë ligjore për detyrim, megjithatë ju premtoj që do të bëjë një takim me perfaqësuesit e barnatoreve dhe në qoftë se egzistonë një vullnet i tyre dhe në qoftë se ne kemi mundësi brenda mundësive tona do të shohim të bëjmë alternativë për të mirën e qytetarëve normalisht. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëpër komunat tjera janë marrë vesh barnatorët dhe kanë bërë me rend se cila të punon në qytet, mirëpo në Viti nuk janë marrë vesh, për shkak që interesi është shumë i vogël dhe nuk kemi mujtë me gjetë ndonjë mirëkuptim deri tashti, përndryshe nuk mundet me i obligu komuna me punu pas 12.

z.Basri Aliu, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyejtet rreth deponive ilegale për shumë vende si në Remnik, ashtu në Belidup, i përmendi në fshatin Ballacë me Terpezë. Për në Remnik e kam vizitu dhe vetë dhe është e vërtetë që është një deponi e madhe e cila është bërë atje. Ne e kemi mendu që të intrevojim në këtë drejtim dhe po shpresoj që brenda muajit maj që do të intervenojmë arsyen për të cilën e kemi shty se edhe ministria bënë fotografimin e tyre, na paraqet deponitë ilegale dhe aty ku na cakton ne mund të veprojmë dhe në mënyrë që të fitojmë performancë për largimin e tyre. Këtu është qëllimi pak që është shty, por gjithësesi do të intervenojmë dhe do të shohim vende tjera që u përmenden. Ne realisht po intrevojim shpesh nëpër deponi ilegale, por prapë po na përsëriten. Ju kisha apelu tek të gjithë që ta keni

parasysh këtë të na ndihmoni rreth këtij drejtimi. Unë dua ta përgëzoj për një deponi ilegale që ka qenë në Kabash rreth lumit “Morava” dhe janë organizu “Lagjja Deliu”, i përgëzoj për iniciativën që e kanë marrë në bashkpunim me neve dhe një operator ekonomik, mendoj që ka qenë vullnetar, na ka ndihmu dhe e kemi eliminu këtë deponi. Është mirë që aty ku jeni të intervenoni të bëni një fushatë, sepse nuk po kemi mundësi detyrimi, edhe pse ne bashkë me drejtorin e inspeksionit po dalim në teren, kemi has në njerëz të cilët kanë hudhë mbeturinat, kemi has edhe nëpër fakturat të cilët kemi intrevnu, por nuk po mjafton vetëm kjo, kështu që është mirë që të gjithë të apelojmë në këtë drejtim, në mënyrë që t’i eliminojmë edhe ato që kanë mbetë. Tek ndriçimi publik në fshatin Skifteraj, është kontraktu një kompani sllovene për efikasitet të energjisë, kështu që ata deri tani kanë bërë ingjizimin e terrenit, dhe në momentin që të fillon të implementohet kjo, do të shohim aty ku mungon ndriçimi ta plotësojmë. Faleminderit!

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ju falenderoj të gjithë këshilltarëve për kontributin që po e jepni dhe shqetësimet të cilat po i ngrisni të marra nga lokalitetet e ndryshme të komunës sonë. Po filloj nga pyetja për kanalizimin në Budrikë, gjegjësisht shqetësimet e familjes Zeqiri të cilët kanë qenë dhe tek ne, ajo që nuk të kanë tregu mirë këshilltare është për shkak se komuna i ka ndërmarë hapat dhe pikërisht në ditët kritike kur me të vërtetë ju ka kthyer kanalizimi në shtëpitë e tyre ka qenë inxhinieri së bashku me kompaninë, por ka qenë e pamundur të intervenohet për shkak të ngritjes së ujit. Besoj në ditët në vijim do të intevenohet dhe do të shikohet mundësia e eliminimit të këtyre defekteve të cilët ti i the para 7-8 vite, por këtu janë më shumë se 10 vite. Te çështja e ujësjellësit është një defekt që më së pakti si qeveri komunale kemi qalu, është çështja e ujësjellësve nëpër Komunën e Vitisë. Unë besoj se kemi fillu mar, nuk jemi tu majtë shpresa, por kemi fillu vetë si komunë së bashku me “Hidromoraven” dhe aty e kanë hap një konkurs në nivel të kompanisë në Gjilan dhe kam bërë një kërkesë për marrjen në mbikqyrje për 3 lokalitete edhe pse është dashtë 5, por 2 nga prerjet e punëve të cilët janë bërë dhe kam bërë kërkesë që me i marrë në menaxhim kompania 3 dhe më vonë hapjen e tenderit dhe eliminimin e defekteve për 2 lokalitete, fjala është për 2 Sllatinat dhe kështu me fillu me ujë të bollshëm të pijës. Ajo çka është më rëndësi, javën e kaluar kam pas 2 takime me drejtorin e gjeodezisë dhe kadastrit, gjegjësisht gjyqtarja që është për shpronësim. Një këshilltare, këtu e ka ngritë një çështje, sun po e gjeni, unë e kisha gjetë, por nuk e gjetë as këshilltari, por e kemi gjetë formulën tjetër që kishim të drejtë me shpronsu pronën edhe në mungesë personit i cili nuk është këtu dhe mjetet me i deponu në bankë qendrore, mi blloku ato dhe në momentin e paraqitjes me ja dhanë, nuk do të jetë ajo bllokadë tash e tutje do të fillojë edhe shpronësimi i asaj pjese për rritjen e kapaciteteve të rezervareve të ujit të pijës në Letnicë. Ilir, shqetësimet e tua duhet me qenë të çdo qytetari të Komunës së Vitisë, në veçanti edhe të udhëheqjes, në këtë rast të kryetarit dhe timit. Unë në dy muajt e fundit kam bërë përpjekje maksimale sa është kapaciteti im dhe pozita ime që e lejon për shkollën e Pozheranit. Kam siguru edhe një takim në ministri për të cilën dje kam qenë, por para 10 dite kam qenë edhe në OSHP. Në OSHP kur kam qenë kam marrë informacion se kanë marrë një ankesë nga një operator ekonomik dhe lënda është në shqyrtim, është caktu ekspert, kam bisedu edhe me ekspertin, ka dalë me raport të cilën raportin nuk e kam shiku, se janë çështje sekrete të atyre, por megjithatë tentativë për me lëvizë këtë guri kam bërë dje, kam qenë vetë i katërti në ministri, na ka pritë shefja e kabinetit me arsyetim se minisiterja ishte në Kuvend dhe Kuvendi ka qenë në thirrje të jashtëzakonshme, edhe pse ajo e ka caktu terminin dhe kam bërë edhe unë arsyeshmërinë se kuvendet e jashtëzakonshme munden me dalë papritmas dhe ndoshta nuk mundesh me ju përmbajt itenerarit të cilin vetë e ke caktu. Takimi nuk ka qenë i lehtë dhe ka qenë pak brengosese, jo nga shefja e kabinetit, se ishte e re, para 3 muajve e kish marrë detyren, por aty merrte pjesë edhe një inxhinier i cili konsideroj ka përvojë bukur të gjatë aty dhe gjithëherë është mundu gjatë tërë takimit me hudhë topin në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Unë nuk e kam bërë rastësisht, se unë kam qenë iniciatori që me të vërtetë ta kem takimin e parë në Ministrinë e Arsimit, nga arsyeshmëria se fati ka dashtë që kam qenë në rrjedhë të problemit dhe fillimisht

mjetet kanë qenë të ndara në Ministrinë e Arsimit për ndërtimin e asaj shkolle dhe në atë kohë ministri i arsimit Arsim Bajrami nuk ka dashtë me u marrë me atë problem, dhe ato mjete ja ka dediku Ministrisë së Administrimit Publik, dhe unë konsideroj dhe sot e mbroj atë qëndrim, se në momentin kur unë dhuroj mjete kam drejtë me pyet për ato mjete deri në përfundim të kryerjes së atij objekti shkollor dhe pikërisht kjo ka qenë arsya pse jam nis në radhë të parë në Ministrinë e Arsimit i kam spjegju këto të gjitha dhe ajo ka qenë korrekte, shefja e kabinetit i ka pranuar edhe këto shqetësimet e tona për orët 20 minut. Në fund kemi ardhë në ujdi se brenda 10 dite më tha mos me ngut deri sa t'i marrë të gjitha informacionet dhe ta dërgoj me shkrim për gjendjen. Unë konsideroj që në rast se nuk do të jemi i kënaqur me përgjegjen të cilën ma jep, se unë jam i kënaqur vetëm kur shkolla fillon dhe kërkesa jonë ka qenë që me 1 shtator nxënësit me hy në mësim, që është problem ajo punë, veç në rast se është një vullnet i madh i tyre mundet me u bë ajo çështje, se ma urgjentë në nivel të Republikës së Kosovës se në Pozheran besoj që nuk ka me këto njohuri të cilët i kam. Nuk do të ndalem pa trokitë në çdo derë që këtë guri me lëvizë edhe pse kanë qenë shumë shkresa nga ana e kryetarit dhe ish drejtoreshes në adresë të ministrive përkatse, tek stadiumi e morre përgjigjen por megjithatë kryetari i komunes e ka bërë edhe një komision për prerjen e punëve dhe unë po ta japë informacionin sapa e morra tu ardhë në seance se mundohem të jem i përgjegjshëm për pyetjet të cilët i bëni dhe këtë pyetje e ke bërë edhe në komitet dhe janë ka barazohen tash si do të delë qështja a kanë me punu hala a po jo a i kem obligime dhe së shpejti do ta keshë një raportë për gjendjen e stadiumit të Pozheranit, Jakup i ngrite 2 shqetsime të cilët me të vertet më shqetsojnë edhe mua, përgjegjje konkrete nuk kam pa e marrë informacionin e plot po të zotohem këtu se do të bëjë përpjekje maksimale ndoshta edhe përmes telefonit të shofë edhe kush është menaxher i projekteve tu i përcjell ato nuk po e them me ironi por me sinqeritet a e ka pa edhe ai këtë dëm i cili po bëhet dhe cilat janë veprimet të cilët ai i ka ndermarr se këto qështja janë duke na ndodhë edhe nëpër vende të tjera të cilët duhet me i eliminu se në rastë se një punë e nreqim një tjetër e prishim.

z.Jakup Demiri: Menaxher i projektit ish Rafiz Shabiu, kam qenë me të, ndërsa menaxher i projektit të rrugës më heret që është shtrur kishte qenë Florim Rama. Me dytë kemi dalë dhe e kemi shiku, por mu deshtë që edhe këtu ta bëjë njoftimin, informaten mundesh me marrë tek të dytë.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Faleminderit për informacionin! Çështja e trotuareve të cilët e ngriti Nexhati. Basriu e di se janë kontrata 2 vjeçare dhe unë besoj se sivjet është përfundimi i asaj çështje që duhet mu kry. Unë i besoj asaj çështje që është e shkruar, derisa për të njëjten nuk është vendos ndryshe. Për rrugën Kërbliq, në cilën fazë jemi edhe me përgatit një raport. Unë nuk e di se sa është e rëndësishme me përgatit raport për Kuvend, për rrugët të cilët janë ndërtu, megjithatë atë që mundem me të njoftu i nderuari këshilltar, me 24.04.2023 kanë qenë në zyren time 2 inxhiner nga ana e ministrisë, të cilët kanë tregu se deri më tani ka qenë një inxhier tjetër mbikëqyrës, por tashti e tutje është Avdyll Ymeri, që në rast se ti je i interesum, mundem me ta dhanë edhe numrin e telefonit me kontakt me të. Po tregoj se tash e tutje përveç festave të cilët mund me i shty, çdo të Enjte do ti kemi takime në ora 9 lidhur me ecurinë e punëve. Aty do të jetë Avdyli, se ishte mbikqyrës i dy rrugeve të cilët investon ministria, që ishte me vendim rrugën e Kerbliqit dhe rrugën alternative të Stubles. Duke e njoftë edhe më herët si profesionist, ju kam gëzu faktit që është ai. Zyrafete besoj se te uji morre përgjigen edhe ti. Tek çështja e bursave dhe nota mesatare që e ngriti njëri prej këshilltarëve, unë konsideroj që duhet të ruhemi në radhë të parë nga fjalori i etiketimeve të njerëzve, ke kush ke ai, megjithatë po jetojmë në shekullin 21 dhe në Kosovë duhet t'i jetësojmë të gjitha organet të cilët e kanë shkallshmërinë e vetë. Në rastë se konsiderojmë që na u ka bërë një të padrejtë, jam idhtar i asaj që me i fuqizu organet, jam idhtar i asaj në mënyrë procedurale me u drejtu kur cenohet një kërkesë e një individi dhe të kërkohet drejtësi, por forma e etiketimeve, forma çka i vyn nota mesatare, i vyn atyre të cilët i kryen dhe unë besoj që ajo është mburrje dhe duhet të jetë mburrje edhe për neve që ata janë studenta të komunës sonë. Musliu tha ka pas shumë ankesa. I nderuar, nuk është hera e parë, është një praktikë në komunën tonë që me

mujtë të gjithë ata të cilët studiojnë me i prek dora e shtetit, edhe bursa e shtetit është burs shtetore, kjo e jona është komunale, por është shtet, prandaj kemi konsideru se ata që i marrin 1 mijë euro ma mirë është një tjetër me mujtë me 1 mijë euro ti i pagun 3 bursista këtu dhe politika të cilët po i ndjek kryetari besoj që është politikë shumë e mirë pa dallime politike, pa dallime në cilin fakultet, por të gjithë ata studentë të cilët janë të regjistruar dhe kanë fitu kushtin që i ndjekin ligjeratat janë studentë të rregullt, fitojnë burs. Unë besoj që duhet me u pajtu edhe ti edhe pse edhe tek ne ka pas shumë ankesa në këtë drejtim unë konsideroj që fëmiju im të kishte qenë bursist i universitetit, që ka ndodhë, nuk e kam leju as me konkuru, se është mirë krejt me i përfshi, krejt bursista nuk mundën me u bë, por është mirë të gjithë mi përfshi nga pak. Me siguri edhe rregullorja të cilën e ka vendos komisioni e thotë në këtë formë, nuk e di detajisht, unë e kam lexu, por harrohen, a është përfill për të gjithë. Konsideroj po, naj një u ka përvjedh një sipas komisionit për shkak se jemi ka punojmë me urgjencë, sidomos javën e fundit, se mundësia e egzekutimit 56 mijë eurove na lejon. Këtë muaj e kanë parapa Drejtoria e Financave në rast se nuk e realizojmë delë në korrik. I kam nënshkru dikun 1200 kopje të vendimeve që me mujtë me arritë afatshmerinë mi egzekutu deri të premtën 56 mi euro dhe pjesa tjetër do të vazhdonë në maj që përfundimi i majit mi zanë të gjithë përfuturit e bursës komunale me mjete në gjirrollogari të tyre, Faleminderit Liridon në radhë të parë në momentin kur i gjenë gabimet drejtëshkrimore unë konsideroj se je përcjellse e punëve dhe të aktiviteteve që të obligon edhe ligji përshkak se je kshilltarë megjithatë hiq nuk është keq edhe ti si kshilltarë e kuvendit komunal se je institucion i organit më të lartë me i korigju dhe me i ndihmu edhe kryetarit në korigjime të gabimeve se dikush ka afirmimet më shumë dikush më nuk ka dhe profesioni nuk i zihet për të madhe kryetarit në rastë se bënë ndonjë gabim drejtëshkrimorë se me profesion është agronom unë jam juristë edhe unë nuk jam i mirë në drejtë shkrim por gjuhëtarët janë më të mirë kjo botë është me mozaik të ndryshëm të profesioneve dhe me i ndihmu, a është mendu për kompenzimin e tokave të cilët ju kanë marrë për rrugën është mendu dhe është ka punohet në atë drejtim por ato nuk bëhen brenda natës edhe pse znj.kshillare unë kam qenë në rrjedhë prej fillimit me banorë në momentin kur e kanë kërku devijimin e rrugës kanë thanë krejt kemi me ja dhanë pa pare po mandej janë joshë 3-4 dhe do ti joshim nuk është problem unë kam qenë në të gjitha takimet jo mi joshë por taman me ja kompenzu se është e tyre prona private është e shejtë aty duhet me bë një ingjizim të gjendjes por tash për momentin nuk mundën dhe me fillu qështjen e shpronsimit, kjo dita e diel nuk është e lehtë në implementim dikuj i konvenon dikujtë jo megjithatë duke pasë parasyshë edhe unë ekam gjithë here këtë Majlindë me skepticizëm këtë se kur Kosova me të madhe zbrazët është brengë edhe e strukturave e nivelit qëndor dhe tasht edhe këtyre hapave ndoshta e ka vajin në buzë hiq nuk shkonë për këtë punë por thot nuk po na lenë edhe me punu këto nuk janë forma të lehta dikush i ka punët më të mirë megjithatë vendimin të cilën do ta merrë kuvendi komunal egzekutiva është obligative me respektu, nxënsi i cili para pak dite ka pas ekcesë në shkollën e Sodovines jerlive jemi kujdes që nga momenti i parë në qdo 2-3 orë na ka raportu përmes telefonit apo gojarishtë drejtoresha e DKA-s Arta Ajeti që u kanë kontakt të vazhdueshëm me nanën e saj apo ti dhe një fatë i mirë që ka shpëtu dhe me sa jam në dijoni ka marrë vendim që klasa me dalë në katin e parë pse ka ndodhë që kanë qenë në katë të dytë ndoshta u kanë edhe ajo autonomia e drejtorave që janë kanë brenda shkollave ku e parashih por megjithatë me qenë në katë të parë nxënsit e klases së parë dhe parafillores është më mirë përshkak edhe vetvlerimit të rrezikut dhe mos me i kanë mu ngritë shkalleve por nuk po e di edhe objektin shkollor diqka ka pasë një arsyesmeri edhe kur i kanë qitë në katë të dytë a ka qenë ndonjë kushtë më mirë a kanë qenë qështjet e tualeteve por ajo që është me rëndësi që nxënsi ka shpetu se do të ishte një brengë, unë konsideroj se pse ju keni ikë unë shpresoj dhe besoj se si kemi ikë askush paraqitjes publike por lajmet të cilat nuk janë të mira unë besoj që nuk ka nevoj për reklamë në televizorë, Remzi dytë vimë nga ai lokalitet e pa kontestueshme qështja e rruges Remnik Budrik, Skifteraj Nasal që është rrugë shumë e rrezikshme kam bërë përpjekje shumë here edhe për këto shenjat e komunikacinit të cilat nuk po i respektojnë

mandej ka dalë si konceptë kto dridhimet që i kemi bërë që edhe ato nuk po i ndalin kur i kemi bërë këto unë nuk kam qenë idhtarë i gungave përshkak që ti e dinë që në Remnik kemi pasë shumë e tani ka ardhë një vendim që i kan largu krejtë thojsha tingllon në këtë anë i kemi hekë këtë anë po qitni por tash i kam parë edhe disa kërkesa nga banoret që kan ardhë që me të vertet me bë diqka në këtë formë që kam kërku prej drejtorit megjithatë në momentin kur fillojn kompanitë me i mirëmbajtë gropat besoj se konfront me inspektorin me dalë dhe jam idhtarë i vendosjes sa në lartsi do të vendosim do i kam parë në Gjilan që i kan vendos shumë të gjata por jo me demtu veturen deri sa e kemi pasë si solicione si qështjen e rrethrotullimit po na qetë problem se duhet me shpronsu janë 4 pronarë se momentalishtë që është nuk e nxen përshkak se aty mundet me pasë rrethrotullim për vetura por aty ja msyn edhe peshat e rënda kamionat që janë me dy rimorkio këtë besoj që këtë vitë kemi me bërë me pengesa dhe e shohim se sa do të jetë efikase kjo çështje. Për deponitë u përgjigj Basria, edhe pse të dielen kam qenë edhe unë, është brengosese ajo çështje. Po na mungon vetëdijësimi jo në lokalitetin tonë, por në të gjitha lokalitetet, por kur e kam parë seriozitetin unë kam bashkpunu ngushtë këtu të Gjypaja, aty është ndalohet hudhja e mbeturinave, edhe kshilli i fshatit ka marrë një vendim kur i prishin këto deponit inerte, por po e vrej qe 2 vite kur është një vendim i kshillit të fshatit dhe një tabelë ka pas sukses se të dielen kam qenë edhe këtu edhe atje, por atje e kam parë shumë të shëmtuar këtu shumë të pastërt, andaj duhet me gjetë një metodologji të cilën e ndalon atë. Sejd, unë ju uroj të gjithëve për fillimin e punimeve në kyqje në autostradë, ajo ka qenë një përpjekje e vazhdueshme, kush më shumë e kush më pak ne nuk kemi peshore me qitë, por megjithatë qëllimi është arritë dhe ka fillu. Unë e di se fillimisht ne kemi pas një kërkesë për zonë industriale në atë pjesë, është refuzu për shkak pak hektar më duket janë 4-5 hektarë po flasë në pronë komunës jo për pronë të AKP-së për çështjen tjetër deri sa nuk bëhet zgjidhja të kalon pronë e komunës. Ne nuk mundemi me bë një çështje të tillë, por kërkesa pse mos me egzistu. Sa ka me mujtë me kalu dhe sa kemi ne kapacitet me jetësu shohim, se ne Vitia veç e kemi bërë një zonë industriale, jemi në përfundim të saj, a kem kapacitet të buxhetit tonë, është çështje tjetër, a do të hasë kërkesa jonë në mirëkuptim në nivel qeverisë së Republikës së Kosovës, unë besoj që disponimi jonë dhe gadishmeria jonë me bashkpunu dhe me bë kërkesa nuk do të mungon, kurse kërkesa nga banorët e di që është mendu shtrumja e asaj pjese në kubza, ku ka mbetë nuk e di gjendjen, po muj me mendu që e kanë gjendjen keq, megjithatë duhet me shiku gjendjen dhe çka është e mundur me eliminu. Faleminderit prej të gjithëve për pyetjet, u mundova të jem i sinqertë.

z.Basri Aliu, drejtori: Kur ke çështje për oborrin e ndërteses, është e projektume ajo dhe po shpresoj që ka me fillu shumë frik, sespe jemi marrë me këtë çështje, sepse vërtetë që gjendja është e rëndë aty, sepse nuk e tërhek ujin aty në kanalazim, është nxënë, e ka pas rrjedhjen e bartjes së ujit, por kur ka punu KEDS-i diku sipas banorëve është zanë gypi, ndërsa për kanalizimet që i përmende, ne e kemi një kompani, është për intevenime të shkurta, po them në atë kuptimin ku ka nevojë, ndërsa rasti që po e paraqetë Valentina është më specifik në kuptimin se ajo ramje paska mbetë me intervenu me projekt tjetër, ndersa në Viti-Pozheran e këto, e ka për detyrë “Hidromorava”.

z.Illir Zuka: Drejtor, faleminderit për përgjigjen. Prej fillimit të mandatit i bëjë dy pyetje shumë me rëndësi për pozheranasit, që nuk kanë zgjidhje problemin e shkollës, po e dimë tashti një problem ende më i madh na paska ndodhë edhe me stadiumin, kur ministria nuk paska parapa, kodë buxhetor për këtë vit asnjë cent. Në qoftë se vazhdon të jetë në këtë gjendje, ka me u shnëdrri si stadiumi i Vitisë, besoj që kanë me fillu me hedhë mbeturina, se nuk ka mbetë për asgjë tjetër që është për gjynah. Qytetarët e Pozheranit dhe “Vllaznia” nuk e meritojnë të jetë stadiumi “Ibrahim Kurteshi”, i cili bënë gara prej viti 1973, të jetë në atë gjendje. Kërkoj nga ti kryesues, e di që nuk është kompetencë e jotja, nga kryetari, nënkryetari, drejtori i kulturës, në rastë që nuk e kryen ministria këtë vit, ta bëjëm një rishikim të buxhetit, Komuna e Vitisë ta përfundoj atë projekt, se është për keqardhje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse tani në rishikim të buxhetit kemi mjetete, ka mesi i vitit së bashku do të synojmë mi shti. Nëse nuk bëhet një zgjidhje, atëherë e shtim në vitin tjetër.

z.Nexhat Halili: Kam një kërkesë të vogël për ujësjellësin në 5 lokalitete. Nënkryetari tha se “Hidromorava” ka shprehë interesim vetëm për 3 lokalitete, por nuk i potencoj se cilat janë ato, cilat po mbesin pa menaxhim.

z.Basri Aliu, drejtori: Nënkryetari i përmendi, tha dy Sllatinat.

z.Nexhat Halili: Raporti për shkollën e Pozheranit, nënkryetari tha është konfidencial, por unë nuk mendoj që është konfidencial. Hynë në web-faqe të organit shqyrtues të prokurimit publik, i shihni përgjigjen e ekspertit shqyrtues. Nënkryetari potencioj se, beson se së shpejti do të filloj trotuari i cili lidh 3 fshtra, mirëpo kjo përgjigje është dhanë që 1 vit. Pika tjetër të rruga Viti-Kërbliq janë ndëru 2 menaxher, ka ardhë menaxheri tjetër. Arsyeja pse janë ndëru ata menaxhra, ka diçka që kanë ngecë punët apo pse është ndëru. Tek kontrata e kanalizimit, edhe më heret drejtor e potencum në Trestenik, nënkryetari potencon që, nuk ka kontratë. Ti drejtor potencove që ka kontratë.

z.Basri Aliu, drejtori: Ke keqkuptu. Sigurisht se nënkryetari nuk tha që ka kontratë, po tha, në qoftë se kemi kontratë, se ai nuk mundet mi ditë të gjitha kontratat, dhe për rastin në Trestenik jemi marrë me ta, por është telashe, për shkak se nuk kemi mundur me intervenu shkak i të reshurave atmosferike, se nuk mundesh me hy me intrevenu me bager, se mbetë bageri. Në momentin që rregullohet koha e kemi që të intervenojmë në atë pjesë. Sa i përket asaj pse është ndëru, ajo koka ndru atje në ministri. Kryetari për këtë mundet me dhanë përgjegje pse e kanë ndëru ata këtë menaxherin, ministria, se kjo çështje nuk është e Komunës. Ne nuk e kemi ndëru tonin, por ata e kanë ndëru të vetin.

z.Musli Neziri: Faleminderit kryesues! Në rregullat që jan caktu ose konkurset që janë caktu aty nuk është parapa një rregull që e largojnë një bursist. Unë prapë qëndrojë prapa mendimit tim, nëse janë 10 studentë në pyetje që e kanë marrë bursen universitetin, ata duhen të motivohen, të dallohen nga të tjeret, sepse është motiv shtesë, prandaj ne nuk duhet t’i demotivojmë. Ne nëse i largojmë prej listës së bursistëve komunal pse e kanë një notë mesatare të mirë, ata duhet me u përkrahë. Edhe te pjesa tjetër e përvjedhjes në lista, nënkryetari tha po se ka pas një gabim, shpresoj të përmisohet, por unë nuk jam kundër kërkujt, e kem të qart, unë jam me i përkrah, domethanë nuk jam kundër që të hiqet dikush, por vetem se të përkrahen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Musli, rregullorja në këtë Kuvend është miratu pa marrë parasysh si del konkursi. Konkursi përmbahet në rregullore që përcakton, rregullorja e ka një kohë që është miratu në Kuvend, i kemi parë disa gjëra që duhet të ndryshohen, se nuk kanë të drejtë as studentët e universiteteve private të konkurojnë. Ndoshta është rëndësishme, unë kam kërkë edhe prej DKA-së, unë kam kërkë që kjo rregullore edhe njëherë të vie në Kuvend dhe të fillojmë me shqyrtu. Ti shohim disa mundësi, aty në rregullore shënon që bursisti nuk merr për shkak që me i dhanë dikujt mundësi që nuk merr asnjë ndihmë, se parimisht të komunës nuk jan bursa, sepse bursa i ka disa kriteret, por janë ndihma për studenta. Më shumë është emru bursë, mirëpo parimisht janë në rregullore të shënuara do gjëra që nganjëherë nuk munden me u tejkalu edhe kur janë gabim. Nëse ne e bëjmë një rregullore gabim, na mbesim që e aplikojmë.

z.Sejdi Emini: Po kyqem pak edhe unë në debatin për studentë. Me sa di sipas komisionit që ka qenë, kriteret i kanë plotësu diku 150 që kanë fitu komuna apo kryetari i ka rritë i ka bërë në 302, e që mirë që e ka rritë, mirëpo ka mbetë pa marrë vetëm 105-106. Nuk e di pse është nda kjo pjesë e vogël nëse ka bë lëshime jashtë kriterëve është dashtë me i bë edhe për këta 106, me përfitu edhe këta. Njëra ndër arsyet që nuk më ka pëlqy fare këtu është, sepse individi që ka dy studentë e ka anashkalu njërin studentë duke ja mohu të drejtën që mos me marrë dy fëmij prej një familje. Realisht ose logjikisht a ma lehtë brenda vitit me majtë një student një familje apo 2 ose 3 studentë që i ka një familje. Një llogari shumë e thjeshtë na qetë në rrugë që, shumë më lehtë është me majtë 1 ose 2. Mendoj që është diskriminim dhe është shkelje ndaj atyre familjeve që i kanë

dy studenta edhe mendoj që duhet prapë me rishqyrtu edhe një here këtë, me i shti këta që kanë mbetë. Te shkolla e Pozheranit u fol mjaftë shumë për një operator, po më intereson ai operator i kahit është dhe kush është. Me sa di unë, pikërishtë i Pozheranit është që e ka koqit shkollën. Faji në të gjendet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pjesa e marrjes së fjalës, e replikës të takon vetem për përgjigjen e pyetjes që e ke bërë. Ne mundemi të diskutojmë me javë të tëra sahere dojmë me qu gishtin mu kyqë në tema tjera. Për këtë është temë e caktume, janë dy pyetje, por nëse nuk ke marrë përgjigje në pyetjen që e ke bërë, mund të kyqesh, por tash me marrë fjalën dhe me hy në pika tjera, ju kisha kërku mos ta keqperdorim pikën.

z.Illir Zuka: Në qoftë se bënë vetëm një spjegim të shkurtë, për shkak të shkollës së Pozheranit, sepse isha i vetmi që bëra pyetjen, se me më rëndësi po është një rrugë rurale apo një trotuar mu bë sesa një shkollë mu ndërta, ku dihet gjendja që është Pozherani. Nënkryeatri tha shumë sakt se është konfidenciale, për shkak që landa është në OSHP. OSHP-ja pa e qitë vendimin nuk të jep asnjë dokument. Nexhati tha diçka tjetër, kështu që veç po interpretohet gabim dhe po keqinformohen qytetarët dhe nuk është e vërtetë që ka pas ankesë prej firmës së Pozheranit. E di që është dalë kjo, nuk e di kujna i konvenon, fitues është një firmë e Prishtinës. Ankesa është prej një kompanisë Istogut, jam merr me këtë punë edhe në OSHP dhe në ministri gjithëkund.

z.Nexhat Halili: Unë vetëm një sygjërim po ta jap Ilir. Hyn në web-faqe të organit shqyrtues, prokurimit publik, e shef përgjigjen e ekspertit shqyrtues. Ajo që aludon ti, hera parë që është bërë ankesa, ajo ka përfunduar, mirëpo tash fituesi që ju ka anuluar tenderi ka bërë kundër ankesës. Hynë në web-faqe e shef.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ky është tu thanë hynë në web-faqe shikoje e ke, ti po thu e kam një vendim që e ka dërguar ministria. Ky po thotë kundër atij vendimi është anku ai dhe presim OSHP-në, nuk kemi nevojë me hy në debat më shumë, janë procedura jashtë neve.

z.Jakup Demiri: Po du me dhanë kontribut pak në këtë, por nuk dua të bëjë debat. Edhe ne e kemi pas dje një takim me ministrin e ambientit, i cili e kishke informatën se çka është tu ndodhë me shkollën e Pozheranit. Brenda 10 dite tha del informata krejt dhe fillon me u punu në shkollën e Pozheranit në detaje. Më shumë nuk mundem me dhanë, ndërsa edhe dy gjëra të tjera po ti them Ilir ty dhe gjithë këtyre. Ankesa nëse ka pas më së shumti dhe zhagjitje apo është keq me than shpijunazha, ka pas prej banorëve vetë të Pozheranit. Kam thanë edhe atë ditë në KPF dhe sot po të themë, ka pas të cilët kanë qu në ministri edhe fotografi për punimet e mëhershme, me një farë forme njerëzit që nuk janë të Komunës së Vitisë nuk e kanë shumë dert shkollën tonë të Pozheranit, ata e marrin ma me rezervë dhe ma me siguri punën e vetë. Janë bërë aty prerje të punimeve, është dashtë me bë raport të detajum, kështu që ta mendojmë këtë punë me kokë të ftofur edhe nga ana e tyre, se njerëzit munden me shku edhe në përgjegjësi për punët e veta secili. Nuk është që po thu Ilir që veç vetë je marrë me atë punë, është një që je marrë më së shumti, por të gjithë kemi qenë të angazhum për me u krye ajo punë. Nuk po dua që dikënd ta bëjmë sikur pengesë. Për këta këtu që jemi, besoj që e kemi barrë edhe për shkak të qytetarëve, përgjegjësitve tona që ky projekt mu bë, e mos të merren me politizu, ta kthejmë politikisht. Në këtë e kam edhe një pyetje që nuk morra përgjigje dashta me ditë edhe një here, te puna mes vorrrezave Kabash-Viti, një intervenim që ka qenë, a ka qenë intervenim prej komunës diçka në kanalizim, a çka ka qenë, por me të vërtetë që ka shumë here që kur bëhen intervenime të tilla, mandej gjendja e tyre mbetet shumë e vrazhdë.

z.Basri Aliu, drejtori: Unë nuk e kam parë, por aty sigurishtë Bashkësia Islame ka ndërhy për atë objektin, por do të dalim në vend të ngjarjes ta shohim.

z.Ali Bajrami: Drejtoreshë, faleminderit për informatën e dhënë, ne kemi votu në Kuvend, kemi marr vendim që me shku përmes ankandit, është emru edhe komisioni, ajo çka ti më informove që është ulë vlera e qirasë, nuk kam pas njohuri si përgjegjëse e atij institucioni që e ke edhe obligim ligjor. Merre kontratën e mëhershme dhe kontratën e re tash që është bërë për sa është dëmtu buxheti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti dhe i Komunës së Vitisë.

znj.Arbnora Hajredini: Më vjen keq që nënkryetari nuk është këtu, se ma kthej përgjegjen. Tregoj në cilin shekull jemi dhe shumë mirë që e dinë që jemi në shekullin 21, ku qytetarëve të Vitisë i mohohet e drejta për punësim. Më vjen shumë keq për këta që janë nis, më tregon për organet kompetente kur mundet me ma tregu veq ligjin me të cilin funksionon lista, e atë ligj nuk jemi tu mujtë me gjetë askund, veç çka mundemi me gjetë rreth asaj liste është që, Prishtina në vitin 2018 është dënu.

znj.Liridona Bislimi: I nderuari drejtor, faleminderit shumë për përgjigjen e dhënë, atëhere mua më duhet vetëm të marrë disa informacione shtesë nëse ka mundësi për banorët e asaj lagje, se kur ka me u fillu me u implemetu më së afërmi ky projekt, nëse ka mundësi ti kemi informacionet shtesë më të detajizuar për shkak se është një problematikë jashtëzakonisht shumë e madhe. E përmenda sidomos për fëmijët të cilët shkojnë në shkollë, mungesa e ndriçimit publik është bërë një problem mjaftë serioz. Edhe nënkryetarin nuk e paskemi këtu, por përgjigjen që ma dha sa i përket gabimeve drejtëshkrimore të parit të komunës sonë, kjo nuk është një vërejtje e drejtuar personalisht nga unë, kjo është një temë diskutimi që është bërë nga qytetarët e Komunës së Vitisë, jo nga unë personalisht. Faleminderit!

z.Basri Aliu, drejtori: Krejt kemi gabime gjuhësore, kështu që nuk do ti bëjmë dabat kësaj pune, por me rëndësi është që esenca me qenë e mirë, dhe besoj që esenca ka qenë e mirë, gabimet teknike ndodhin, kështu që nuk është telashe kjo punë. Përsa i përket ndriçimit, nuk mund të themë kohë të sakt, sepse operatori e ka bërë ingjizimin e terrenit dhe prioritetet ndoshta fillojnë prej qytetit të Vitisë nderkohë sa e di unë brenda 6 muajve ai duhet me ndrru ndriçimin egzistues në mënyr që me fillu edhe me ndriçim tjetër ku ka nevoj, ne si Viti shpresoj që kogjo territor të komunës kemi ndriçim publikë por nuk do të thotë që edhe në ato vende ku nuk ka mos me pasë përshkak të efijenteës që është sigurisht që është mundësia më e madhe, sepse do të ketë ruajtje të buxhetit në mënyrë që të ketë mundësi të shtojmë edhe ndriçimin dikund tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materialin e keni marrë me kohë, për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal.**
- 2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2023.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndekomunal ndemjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të mbeturinave.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain Gjermani.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vitisë.**
- 7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-110/05-108, të datës 01.02.2022 për plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-974, të datës 28.12.2021 për formimin e Komiteti për Komunitete.**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për rendë të ditës. Pasi që nuk ka për debat, kërkoj nga ju që me ngritje të dorës të votohet rendi i ditës. Me 21 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Para se ta hapi diskutimin, më duhet të tregoj se, 5 faqet e para janë të lektorume, faqet tjera nuk kanë qenë të lektorume kur ju ka ardhë materiali, ndërsa tani janë të lektoruara edhe pjesa tjetër. Nëse ka diçka për procesverbal, urdhëroni.

z.Remzi Salihu: Tek procesverbal unë e kisha një ndërhyrje tek fjalimi im në faqe 3, në rreshtin e katër, aty ka mesazh të ndryshohet fjala vjen dhe të zëvendësohet me fjalën vlenë, por edhe atë me lanë po e shofë që nuk po qonë ndryshim, se ka fillu kështu, pra në vend të fjalës vjen edhe fjala vlenë. E kisha ndryshu edhe një fjalë tjetër, por nuk dua ta ndryshoj, se ashtu e kam thanë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse nuk ka vërejtje të tjera, atëhere me ngritje të dorës kërkoj miratimin e procesverbalit. Pra, nga të gjithë të pranishmit me vota pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbalit me këtë ndryshim.

Si pikë e dytë e rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2023

z.Besnik Imeri, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në bazë të ligjeve në fuqi, para juve paraqes pasqyrat financiare, por edhe informatatë financiare për 3-mujorin e parë të vitit 2023, buxheti i alokuar për periudhën janar-mars 2023 nga fondet burimore, grandit qeveritar, të hyrat vetanake dhe donacionet janë 3 milion e 112 mijë e 913 euro e 40 cent, ndërsa shpenzimet për këtë periudhë janë 2 milion e 949 mijë e 641 euro e 98 cent. Shkalla e ekzekutimit të buxhetit për këtë periudhë është 94.76% në krahasim me alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike. Të hyrat vetanake gjatë kësaj periudhe janë në vlerë prej 248 mijë e 894 euro e 28 cent. Shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 23.64%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën janar-mars 2022, 1 vit më herët të hyrat në këtë vit janë më të larta për 81 mijë e 422 euro e 80 cent. Shpenzimet për këtë periudhë në kategori ekonomike i kemi si vijon: pagat dhe shtesat 2 milion e 148 mijë 754 euro e 86 cent apo 99.96%; mallrat dhe shërbime 319 mijë 847 euro e 86 cent apo 70.09%; komunalit kemi 63 mijë e 430 euro e 68 cent apo 81.17%; subvencionet, ekzekutime kemi 47 mijë e 932 euro apo 85.52%, ndërsa tek kategoria e kapitaleve kemi 369 mijë e 676 euro e 58 cent apo 99.18%. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit për këtë 3 muajor në krahasim me alokimet është 94.76%. Ja vlen të ndalemi vetëm tek të hyrat nga tatimi në pronë, të cilat janë më të larta për 74 mijë e 829 euro e 40 cent dhe donacionet të cilët në krahasim me vitet e kaluara që nuk kemi pas në këtë 3 muajor janë 580 mijë e 450 euro e 0.5 cent. Këto donacione vinë nga grandit i performancës, konkretisht pjesa e Demosist. Pra, këtu ishin në pika të shkurtura për pyetje shtesë, jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Remzi Salihu: Një pyetje e kam për drejtorin. Drejtor, e di që kjo nuk është në kompetencën tuaj, por megjithëse ke vënë nënshkrimin në fund, për krejt këto që janë, kisha me pyet te prezantimi analitik i investimeve për periudhën janar-mars 2023, domethënë nën 4 i kemi të renditura vendet apo fshatrat ku është intervenu dhe thotë me zhavorr. Këtu figuron edhe fshati Remnik, kështu që unë nuk di që është bërë ndonjë intervenim brenda kësaj periudhe 3 vjeçare në fshatin Remnik. Ndoshta mund të jetë nga viti paraprak, ku procedurat nuk kanë leju të bëhet pagesa, por me sa di unë, nuk di që 3 muaj e fundit të vitit është bërë diçka një intervenim i tillë, prandaj kisha kërku që në seancën e ardhshme me shkrim të ma sjelljes të kërkosh nga inxhinierat se ata e dinë këtë punë se në cilën rrugë është bërë shtrirja e këtij zhavorrit dhe në çfarë kilometra dhe çfarë sasi e zhavorrit është shtruar, dhe në fund kostoja e këtij intervenimi, se këtu shkrun 20 mijë euro, por janë edhe disa fshatra të tjera.

z.Ali Bajrami: Faleminderit kryesues për fjalën e dhënë, faleminderit drejtor për pasqyrat që na prezantove në pika të shkurtura, materialin të gjithë e kemi marrë, janë të gjitha të specifikume, duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike, i kemi pasqyrat financiare janar-mars 2023. Është një buxhet që për këtë 3 mujor është shfrytëzuar në përqindje 94.76%. Si zakonisht shpenzimin më të madh në përqindje e kemi në pagat, është 99%, pjesa tjetër që vlenë të cekët në këtë periudhë kohore është që kemi bazuar dhe klasifikuar në të hyrat 2022. Me këtë periudhë 2023 rritje të hyrave 81 mijë e 422 euro që i kisha përgëzu për punën dhe angazhimin që e kanë bërë të gjithë ata që kanë kontribu në këtë rritje tek të hyrat pjesa tjetër buxhet i alokum dhe i shpenzum 3 milion e 112 mijë euro i shpenzuar është 2 milion e 949 mijë euro që na jep përqindjen që e përmenda 94.76%, ajo që kisha cek dhe që vlenë të ceket është se, kemi edhe në projekte të investimeve kapitale një shpenzim solid për këtë 3-mujor, tu e ditë që është fillimi i vitit edhe është periudhë kohore kur më tepër fillojnë procedurat e tenderimit dhe hapja e tendereve për fillimin e 3-mujorit të tretë dhe të katër që kryhet pjesa dërmuese e punëve. Nuk ju kisha marrë kohë më tepër. Faleminderit për vemendje!

z.Zyrafete Rama: Kam një pyetje për drejtorin e financave, te kodi 13/460 shërbimet kontraktuse tjera, me vlerë 42 mijë euro. Drejtor, a mundesh me na spjegu pak ku janë hargju këto para, me që edhe përshkrimi nuk është shumë definues, megjithatë ne po i shohim këtu shpenzime të rrymës, ujit, sado pak po e dimë se ku janë shpenzu, ndërsa tek përshkrimi shërbimet kontraktuese tjera edhe përshkrimi është jo definues, por edhe shuma është shumë e lartë. Faleminderit!

z.Nexhat Halili: Drejtori i financave laburoj të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Të hyrat kanë rritje diku 81 mijë e 422.80 euro. Drejtor, çka ka ndiku në këtë rritje, arsya që është rritë të përgëzoj nëse është reale edhe nëse është e vërtetë që është bërë rritja. Tek pika 2.1, tatimi në pronë dhe tokë të hyrat planifikuara për 3-mujorin e parë janë 162mi e 551.25 ndersa shkalla e realizimit 14459071 një diferencë minus 17 mi e 960.46 pytja ose elaburim kështu gjatë planifikimit dhe krahasimin gjatë planifikimit dhe realizimit gjatë planifikimit keni bërë planifikimin pa rritje e realizimi bëhet me rritje. Vetëm këtu po dua pak një sygjërim, pika 11 të hyrat tjera. Drejtor, këtu te 3 pozicionet i keni vërejt vlerat 0, kështu keni vepru edhe në 2022 me vlera 0, por je edhe 2021 dhe jo edhe gjatë përgaditjes së pasqyrave financiare përfundimtare të vitit 2022. Gjatë përgaditjes së pasqyrave financiare të vitit 2022, planifikimin e keni 0, ndërsa shkalla e realizimit është 238 mijë e 253.43 euro që ju ka ardhë dhe rritje e inkasimit. Tash po dalim te shpenzimet, shkalla e realizimit për mallra dhe shërbime është diku 70.09%, vlera e cila nuk është realizu është 136498.66, çka ka ndiku që nuk është realizu kur e dimë që përmes shërbimeve dhe mallra, bëni dhe pagesen e personave e punëtorëve që janë në kontratë mbi veprë, që numri i punëtorëve në kontratë mbi veper është enormë. Kodi 1900, pagesa për vendime gjyqësore, kemi rritje këtë vit në krahasim me vitin tjetër, por pse nuk po e laburoni se çka janë këto vendime gjyqësore, ne nuk po mundemi me ditë a janë vendime gjyqësore për mospagesen e ndonjë projekti, a janë vendime për mospagesen e punëtorëve të arsimit, apo punëtorëve shëndetësor, një elaburim. Kodi 1340 shërbime të ndryshme shëndetësore. Kjo më shumë vlen ndoshta te drejtoresha. I njëjti rast është edhe ky, edhe këtu nuk ka kurrfarë elaburimi. Të njëjtin rast e ke edhe shërbime tjera kontraktuese, të paktën të jetë një elaburim. Ta dimë pak për afërsisht ku është tu shpenzu ky buxhet i komunës sonë apo buxhet i Kosovës. Tek Drejtorja e Administratës, drejtori nuk qenka këtu. Kam një pyetje, a muj me përgëzu, a nuk mundem me përgëzu derivatet për ngroje qëndrore janë 0. Çka ka ndiku asnjë shpenzim prej derivateve për ngrohje qendrore, kur vlera e vitit kalum ka qenë 7 mijë 346.87 euro. Drejtorja e Bujqësisë tek subvencionet në pasqyrat e prezentuara të vitit të kaluar, 30 mijë e 546 e 25 cent, vlerë të cilën është bërë për pagesa për vendime gjyqësore, prej subvencioneve të Drejtorisë së Bujqësisë, këto mjete a janë parapa në këtë vit se mund të ndodhë që këto mjete të subvencioneve për Drejtorinë e Bujqësisë mund të jenë edhe participim i qytetareve. A janë bartë këtë vit këto mjete, se këto ju kanë marr Drejtorisë së Bujqësisë vitin e kalum prej

vendimeve gjyqësore. Tek shërbimet publike e keni vlerën 26 mijë e 605.24 euro. Çka pastrimi i borës apo çka tek investimet kapitale, të gjitha investimet i potencoj edhe kolega. Shihen investime që janë të barturta prej vitit të kaluar, nuk ka investim të këtij viti. Kjo vlenë për të gjitha, tash shihet rruga Sllatinë-Viti, e potencoj edhe kolegia, një e reshur deri diku e mbulon krejt thuajse bëhet liqë. Faleminderit!

z.Musli Neziri: Dashta me u ndërlihdë tek kjo pjesa e tatimi në pronë, që kemi një rritje prej 74 mijë eurove dhe kur e dimë që edhe neser është afati me pagu për raten e parë të tatimit në pronë. Ne e dimë që edhe qeveria e ka nis atje ligjin. Çka do të bëhet tani me qytetarët, a do të vazhdojnë me pagu a do të penalizohet, a do të ju rikthehen këto, a keni parapa këtu, sepse e kemi një rritje të madhe në krahasim kur i keni bërë periudhën janar-mars 2022 dhe janar-mars 2023, si dhe te krahasimi i shpenzimeve ku keni pas te kodi buxhetor 14/020, mirëmbajtja e ndërtesave, kur i keni krahasu këtu edhe në 2022 tremujori parë edhe 2023 40 mijë e 839.92 cent te dy vitet e njëjta. A është bërë ndonjë pagesë që ka mbetë pa u pagu, domethanë janë shifrat e njëjta, mos ju ka bartë kjo veq copy-paste po përputhet çdo vlerë.

znj.Liridona Bislimi: Sa i përket pasqyrave financiare të bugjetit komunal për peridhuen janar-mars 2023, unë kam disa çështje të cilat kisha dashtë me diskutu dhe me pas përgjigje në mënyrë specifike drejtor, të cilat nuk ka mundësi mi pas. Tash ka mundësi me mi ofru përmes e-mailit zyrtar. Kisha kalu tek pasqyrat e egzekutimit të buxhetit për të gjitha njësitë buxhetore, kodi 13/430 tek shërbimet e ndryshme shëndetësore e kemi një shumë e cila është afer..... dhe gjatë asaj periudhe kemi pasur një shpenzim prej 46 mijë euro për periudhën janar-mars 2022. Pra, po flasim për një shumë mbi 37 mijë euro diferencë shpenzimesh. Tek kodi shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshill kodi 13/440 nuk ka qenë ky kond më herët. Pra, është një kod i ri. Po më intereson me ditë se çka përfshihet përbrenda këtij kodi. Tek sigurimi i automjeteve, kodi 13/950 e kemi shumë mbi 1 mijë euro, ndërsa për peridhën janar-mars 2022 ka qenë shuma e shpenzuar 627 euro. Pra, kemi mbi 1 mijë euro shpenzime kosto më shumë. Tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve e kemi 8 mijë euro, ndërsa gjatë vitit të kalum për periudhën e njëjtë është 6 mijë euro. Pra, po flasim për afër 2 mijë euro kosto më e lartë, ndërsa ajo çka ka qenë më shqetsuse për Lëvizjen Vetëvendosje është mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve, e cila është me vlerë 19 mijë euro, ndërsa për periudhën e njëjtë janar-mars 2022 ka qenë vetëm 1 mijë euro e 324. Pra, po flasim mbi 18 mijë euro diferencë shpenzimesh. Pse ka ndodhë kështu drejtor, ndërsa për drekat zyrtare të cilat e kanë koston për këtë periudhë 11 mijë euro. Për peridhën e njëjtë paraprake për janar-mars 2022 ka qenë vetëm 4774 euro. Pra, po flasim mbi 6 mijë euro diferencë kosto shpenzimesh. Tek Zyra e Kryetarit, tek shërbimet kontarktuese tjera kemi shpenzime mbi 17 mijë euro, ndërsa për periudhën paraprake të njëjtë janar-mars 2022 e kemi 8 mijë euro. Pra, po flasim për një shumë mbi 8 mijë euro shpenzimesh, diferencë më të mëdha nga ky vit me vitin e njëjtë për periudhën 3 mujore. Tek drekat zyrtare kemi shpenzime nga Zyra e Kryetarit mbi 4 mijë euro, ndërsa gjatë vitit të kaluar për drekat zyrtare për periudhën e njëjtë janar-mars 2022 janë 699 euro. Pra, po flasim mbi 4 mijë euro diferencë më shumë për dreka zyrtare nga Zyra e Kryetarit. Pra, nëse e përfshim të gjithë shumën, gjithsej shpenzime që janë bërë mbi 129 mijë euro kemi diferencë me vitin paraprake janar, shkurt, mars 2022, 44 mijë euro më shumë, për shkak se gjatë periudhës së njëjtë gjithësej shpenzimet janë bërë 85 mijë euro. Sa i përket tek administrata edhe personeli, tek paga neto, shuma është mbi 41 mijë euro, ndërsa për peridhën e njëjtë paraprake janë 33 mijë euro, pra plus 8 mijë diferencë shpenzimesh janë bërë për periudhën e njëjtë. Tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve e kemi mbi 1 mijë euro për periudhën e njëjtë janar-mars 2022 ka qenë 303 euro. Pra, po flasim për 992 euro më shumë shpenzime, dhe në fund totali i shpenzimeve i bie të jetë mbi 54 mijë euro, ndërsa për periudhën e njëjtë janar-mars 2022 janë 49 mijë euro, që i bie kemi pas diferencë mbi 5 mijë euro më shumë shpenzime. Unë kisha vazhdu edhe më tutje për shkak që diferenca të njëjta janë në të gjitha kodet buxhetore, mirëpo po kërkoj vetëm për këto fillimisht me pas përgjigje. Për shkak se është një shumë shumë e madhe,

diferencë për periudhë të njejtë, vetëm dallim janë vitet dhe kjo është kosto e qytetarëve tanë. Nuk janë paratë tona private i nderuari nënkryetar. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Duke e pas parasysh që vitin e kaluar 2 muajt e parë ka qenë i bllokuar buxheti, domethanë kanë fillu pagesat sivjet më heret se sa vitin e kaluar.

znj.Majlinda Shabani: Sa i përket raportit të pasqyrave financiare për periudhën janar-mars 2023, natyrisht që e konsideroj që është një raport shumë i rëndësishëm, sepse edhe neve asamblistëve na shpaloset pak a shumë se ku janë shku shpenzimet, dhe i kemi shumë më të qartë pasqyrën e qeverisjes, ku fatkeqësisht tu i marrë parasysh kërkesat dhe paknaqësitë e qytetarëve, konsideroj që është një qeverisje jo adekuate. Natyrisht që qytetarëve të Komunës së Vitisë ju intereson se ku po shkojnë parat publike. Pa dashtë me i përsëritë temat e njëjta që i diskutun koleget asamblistë, unë më shumë isha ndal te investimet kapitale që janë bërë në këtë periudhë, sepse konsideroj që zotësia e komunës shihet pikërisht këtu, përpos shpenzimeve në mallra dhe shërbime, ku natyrisht që edhe në këtë periudhë shohim që kemi pas shpenzime lukuksi. Pjesa tjetër janë obligime të cilat duhet të kryhen në periudhat e caktuara edhe në fund të fundit nuk është që kërkon shumë zotësi. Çështja e parë që për mua ka qenë shumë shqetësuese dhe po e potencoj përsëri është për keqardhje që parat nga taksat e qytetarëve për çdo vit, për çdo 3 mujorë shkojnë për vendime gjyqësore, ku edhe këtë 3 mujor i kemi përafërsisht rreth 75 mijë euro. Po ashtu shqetësuese për mua ka qenë edhe sipas shifrave të punëtorëve të angazhuara me shërbime të veçanta të prezantuara në raportin e ministrisë, Komuna e Vitisë është në numër rekord. Në vitin 2022 nënkryetar i ke 100 punëtorë të kontraktuar me këto kontrata. Pyetja ime është se, çfarë pune bëjnë këta punëtorë. Dhe pyetja ime tjetër është që, si komunë a nuk kemi punëtorë të tjerë të cilët duhet me qenë me kontratë. Natyrisht që nuk jam kundër punësimit, por konsideroj që kjo është shumë shqetësuese, përkundër faktit që e kam parë që ndoshta Komuna e Gjilanit tu e marrë parasysh teritorin, numrin e popullsisë që e ka, i ka vetëm 29 punëtorë të kontraktuar me kësi lloj kontrate, kështu që kisha dashtë një sqarim për sa i përket kësaj. Po ndalem tashti në prezantimin analitik të investimeve për periudhën janar-mars 2023. E kemi parë përshkrimin e investimit. Pyetja ime e parë është se a jan realizuar në këtë periudhë këto investime apo vetëm janë ekzekutuar mjetet financiare, sepse e potencum disa here natyrshtë që edhe në prezantimin analitik në renditjen e 4, shofë që është bërë ndërtimi i rrugëve në fshatin Lubishtë, ku faktikisht nuk jam e informume nëse është bërë ndonjë ndërtim i rrugës. Gjithashtu te riparimi i shkollave, kisha dashtë me ditë se çfarë riparime janë bërë në këto shkolla dhe në përgjithësi e shohim që në çdo prezantim kemi ndërtim të rrugëve me zhavorr, asfaltim, asfaltim, asfaltim. Unë e kisha bërë një lloj propozimi nënkryetarit dhe kryetarit, që fokusimin më të madh në investimet kapitale me pas në çështje të cilat tash e sa vite veç jemi tu i diskutu. Prioritet ndashta ish kanë mirë me pas çështjen e ujit, se ashtu kështu unë po besoj që në fund të mandatit viti i fundit si çdo vit është vit i asfaltimeve, ku çdo qytetari i shkon asfalti deri te dera e shtëpisë. Diçka tjetër që po dua me diskutu ka të bëjë me çështjen e projekteve investimeve të cilat natyrisht që duhet të planifikohen, edhe meqense tashtë është koha ku bëhet ky lloj planifikimi, unë nuk e di se a është marrë ndonjëherë përsipër kërkesa nga këshillat e fshtrave të cilat i kanë pas domethanë pikërisht sot 1 vit në mbledhjen e mbajtur me Këshillin e Fshatit Lubishtë. Unë kam dorëzuar diku 4 kërkesa drejtorive përkatëse për sa i përket kërksave që i kanë pas fshatit Lubishtë. Njëra prej kërksave ku kam marrë premtim nga ish drejtoresha e arsimit që nuk është këtu, ka qenë për shkollën e fshatit Lubishtë, ku ka pas problem me myk, ku kam kërku mu nda një kod buxhetor i posaqëm për kulmin e asaj shkolle më ka premtu që në vitin 2023. Në fillim të vitit kanë me u nda ato mjete, ato mjete prapë nuk janë nda, kështu që unë kisha dashtë një vëmendje shumë të madhe prej nivelit ekzekutiv, menaxhimin e projekteve me investime planifikimin që e bëni. Unë e di që duhet me bë në kuadër të kërksave që qytetarët i kanë dhe sidomos me u marrë përsipër kërkesat nga këshillat e fshatit. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ju kisha kërku që mos ta tejkalojmë nganjëhere veten, por të flasim dhe kërkojmë përgjegjësi për projektet që i kemi votu këtu, se ne për këtë kur ta votojmë buxhetin, i votojmë disa punë që kanë me u kry. Nuk mundën me u kry punë jashtë atyre projekteve që i votojmë, sepse është shkelje e ligjit. Nëse punohen jashtë atyre që i votojmë, ne nuk ka të drejtë egzekutivi me kry projekte çka nuk kalojnë nëpër Kuvend për këtë miratimi i buxhetit e orienton buxhetin ndaras për punët që i votojmë. Këtu duhet me lypë përgjegjësi.

z.Basri Sylejmani: Këtu më së shumti është tu bë për shkak televizionit edhe me dalë në televizion se janë tu fol diçka. Por unë kisha me thanë mu nderlidhë me Majlinden, se shpenzimet e ushqimit të kryetarit të kokan shumë të mëdha, a kjo nuk e llogaritet që para 1 viti bifteki ka qenë 6 euro, sot është 16 euro, ato shpenzimet i kan ngritë restaurantet jo kryetari, e këta veç e shohin që qaty a nuk e bënë llogari se kryatri ka punu më shumë se krejtë kryetarët që kanë qenë deri sot.

z.Ali Bajrami: Unë çështjen e shpenzimeve do ta shtroj me një rrafsh tjetër. Nuk e pata ndërmend me diskutu se diskutimit si shef i grupit e përfundova, është përkeqardhje dhe për habitje me u bë krahasimi i shpenzimeve 2022 me 2023, në shtator po e lypi tashti ndihmen e drejtorit të financave për sa e kemi buxhetin më të madh 2023 në moment që votohet buxheti që ka rritje. Rritje kanë edhe shpenzimet sikur qendronin këto që u thanë prej Vetëvendosjes, dikush duhet të shkoj në përgjegjësi të gjitha këto mjete që janë shpenzu, janë shpenzu në harmoni me ligjin dhe në harmoni me buxhetin që e kemi votu në shtator të 2022 nuk ka asnjë cent tejkalim, se nuk guxon me pas për atë është buxhet që votohet miratohet edhe procedohet fillon të zbatohet në vitin kalendarik janar-dhjetor 2023. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Tash pasi dulen në këtë rrafshin e kundërshtimeve politike, unë po e vazhdoj. Me këtë nuk kam pyetje për këtë kur të folë drejtori. Për shefin e grupit parlamentar të LDK-së, unë ja sqaroj një gjë. Unë vie prej fshatit Smirë dhe kemi një 5 prioritet të dorëzume në Komunën tonë të Vitisë të cilat asnjë nuk është marrë parasysh, ndërsa Komuna e Vitisë ekzekutivi këtu nëse nuk është keqpërdorim apo anashkalim i ligjit në këtë rast, atëherit ne të ma dokumenton me argumente, do të thotë e shtron një rrugë që nuk është prioritet i fshatit të cilën nuk e di shumë, por me siguri kogjo kosto se diku mbi 1 km veç e ka 1 meter trashsi gurë që duhet me qitë zhavor, është një vlerë kogjo e madhe, do të thotë që e ka prishë një rrugë tjetër ne qeto prioretet e fshatit, se paret që ndahen për fshat tonë janë investime që i takojnë fshatit në bazë për kokë banor që është i rregullum si bëhen buxhetet edhe tashtë qato që nuk e ka parapa qytetari i Smirës përmes kshillit të fshatit ta bie komuna përmes njerëzve, linjave të ndryshme sikur ka ndodhë deri tashti a nuk është kjo shkelje e ligjit. Tashti kjo rruga që është shtru para 3 viteve duhet me shtru edhe njëhere se e kanë prish krejt, edhe ai investim që bëhet aty zyrtari nuk e bënë prej gjepit të vet, por e bënë në kuadër të investimeve që i ka të parapame për shatin Smirë brenda 4 viteve qysh e parashih edhe ligji thotë paret ndahen për kokë banori prej njësisë qendrore të buxhetit të shtetit, mandej komuna ka për obligim me i hartu projektet edhe me bë investimet e projekteve në bazë të prioriteteve që i përcakton ai lokalitet me përfaqësuesit e vetë e të cilët nuk respektohen. A është shkelje e ligjit kjo. Në rend të parë është keqmenaxhim i financave, për shkak se bëhen marrëveshje me njerëz të tjerë me politika të ndryshme me interesa të ndryshme dhe nuk përfillen kërkesat e kshillit të fshatit, e këtë rast a nuk është kjo shkelje. Tjetra është për vetëm se mos i merrni këto personale, debat jemi tu bë edhe për kolegun Ramadanin nuk ke nevojë me reagu në këtë formë, secili e ka të drejtën e fjalës, kujt nuk i ndëgjohet mundet me gjetë edhe forma të tjera, nuk kam qef me i pa këto reagime, ndërsa muhabeti i Basrisë nuk më pëlqen, se nuk po du me dalë në domenin e hajgareve bifteku. Nuk paguhet kryetari i komunës për biftek. Projektet e komunës sonë, sidomos këto projektet që janë kohëve të fundit janë veç sa për të dëshiruar si thojnë. E kemi rrugën e Sllatinës, me sa probleme kemi pas edhe në fundë na mbuloj krejt uji me një rigë shi, ndërsa projekti në Smirë që është punu, nuk deshta me bë shumë të madhe, revolta është shumë e madhe në fshat, por kjo i bie një shprehje popullore prej shpisë ma rahat. Ne në rrugë, në mal tu qu

që nuk i duhet askujtë, gati shumë pak, se të paktën bile ashtu nuk ka pas nevojë gjithë ai investim me hy atje, se nuk kemi ndonjë laverdi kumeditë sa për atë rrugë ashtu.

z.Ramadan Deliu: Po më vie keq, por unë reagova më së pari për drekat e kryetarit falë qeverisjes së mirë komunale të Komunës së Vitisë, çdo 3-4 ditë ke ambasador, ki njerëz të huaj që e vizitojnë Vitinë, atyre normal që duhet me ja u qitë nga një kafe, diçka. Nuk mundet kryetari me ardhë me na vetë neve, po ja u qes nga një kafe atyre. E dyta, këta po bëjnë ligjerata sikur me qenë në fakultet. E treta, e ngova parzit Jakupin, kjo është e paligjshme. Kush je ti me vlersu a është e paligjshme apo e ligjshme, është gjykata, qoje në prokurori, ata e vlerësojnë e jo ti e unë me gjyku se a është e pa ligjshme apo e ligjshme.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Për këtë është e parapame që në bazë të Ligjit, pasqyrat financiare të vinë në kuvend dhe të diskutohen financat edhe votohen në kuvend si ka me i shpenzu qeverisja, kurse qeverisja jep informatë si i ka shpenzu. Tash ne këtu në Kuvend mund të diskutojmë dhe me bë pyetje, dhe drejtori e ka për detyrë me dhanë sqarime për pyetjet që i merr.

z.Jakup Demiri: Ne jemi këshilltar të Kuvendit Komunal Ramadan, ne e kemi obligim këto dokumente që i kemi marrë me i shqyrtu këto projektet në Viti, bile këtu ka qenë idea e Nexhatit, por e kam lanë për KPF-në e ardhshme me formu një komitet për përcjellje të projekteve në Viti, sidomos të investimeve kapitale, që unë ka me bë propozim që me bë një komitet dhe me përcjellë, ndërsa a jam a s'jam i thirrur me kqyrë a është në ligjshmeri a nuk është, nuk është e thame me trajtu në atë formë Ramadan, por unë e di se si bëhet buxheti i Komunës, se kam shku edhe nëpër trajnime, ne të gjithë si asamblistë duhet me i ditë punët dhe detyrat e tona. Mendoj që është në domenin e punës sonë që e bëjmë këtë, mos e merrni ashtu, edhe cilësimet ashtu nuk është që i pranoj shumë e mos të shkojmë edhe më tutje.

z.Nexhat Halili: Një koment krahasimi bëhet ndër vite drejtor i financave. Krahasimin e ke bërë edhe në pasqyra ndër vite 2022-2023, krahasimi bëhet si për shpenzime ashtu edhe për të hyrat.

z.Ali Bajrami: Kryesues, edhe një here po e potencoj, votimi i buxhetit nga ky kuvend nga këta assembleista është obligim ligjorë i kryetarit të komunës që nuk guxon me bë për asnjë euro shmangie, se për 1 euro shkon në përgjegjësi, prandaj krejt këto fjalë po më duken të tepërta, se buxheti për atë votohet, janë mjetet, shperndahen, edhe një kryetar i përgjegjshëm i shpenzon aty ku ka nevojë në Komunë të Vitisë. Një fatë i mirë është që, buxhetin, sidomos ato për investime kapitale, gjithëhere mbi 99% ka qenë.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Faleminderit kryesues, faleminderit drejtor dhe të gjithë këshilltarëve ju falenderoj për pyetjet, sqarimet të cilat i kërkojnë në kuader të pasqyrave financiare, për shkak se nga përvoja që keni edhe ju e dini se pasqyrat financiare paraqesin një raport për një gjendje të kalur, të cilët nuk guxojmë me thanë kurrsesi se nuk është e saktë. Ato janë të sakta, kanë ndodhë në atë formë. Tash a ka mundur të ndodhë diçka tjetër, prandaj ekzekutiva është aty për me u përmirësu. Ju jeni këtu për me i dhanë vërejtjet dhe sugjerimet, megjithatë me u ndryshu nuk guxon, se ëshë një sen që ka ndodhë, e dinë ekonomistat dhe duhet me qitë ashtu si ka ndodhë, por ajo që më shtini se nuk e kisha ndërmend ta marrë fjalën, megjithatë në rast se kam gabu kërkoj falje që kam marr gabim, por unë rrall gaboj me kësi gjëra, se mundohem me qenë shumë i përpiktë. Liridona Bislimi më thotë se, nënkryetar, ato janë para të qytetarëve nuk jan tuat. Unë nuk kam thanë që janë të miat, aq e pakuptimt tani dole, se unë kurr nuk kam thanë që janë të miat. Në rast se me ke ndëgju ndonjëhere në jeten time 60 vjeqare që kam thanë këto pare janë të miat, kurr ti ke thënë janë ingjizimet, prandaj duhet me qenë e përgjegjshme sa ti je përgjegjshme, se ato pare janë të qytearëve, ne kemi një barrë pak më të madhe për shkak se jemi ekzkuativ dhe i ekzekutojmë dhe nënshkrujmë dhe kemi përgjegjshmërinë shumë më të madhe, se përndryshe mundesh me u përgjegj për ato pare ku i ke hargju apo formën dhe mënyrën e procedimit të mëtutjeshëm, se si janë hargju. Hala më shqetësuese është Majlindë, megjithë respektin kur thua kjo qeverisje nuk është qeverisje joadekuate, por nuk të vesin ty qytetarët, mos bënë hajgare kjo qeverisje thua nuk është jo adekuate. Jo ashtu është Jakup, në rast

se ti reagon se nuk po të pëlqen një çështje këtu, duhet me reagu si shef i grupit me thënë, nuk kemi të drejtë me i thanë. Mu nuk është tu më konvenu qeveria e nivelit qëndror, por 50.28% ja kanë dhanë qytetarët dhe unë e njof kryeminister dhe nuk kam drejtë me thanë që nuk është adekuate, se ka vendos diksuh tjetër, nuk po je parimor hiq në këtë drejtim, se duhet me tërheq, ato kanë qenë para 1 viti e diçka, qytetarët e kanë vendos kur vinë gara tjetër, atë që e vendosin. Unë konsideroj se, ajo qeverisje është adekuate se ashtu kanë mendu qytetarët sa ka me realizu programin diçka tjetër është. Vendimet gjyqësore, pjesa dërmuese të cilët i thua ju e dini se burimin e kanë nga kontratat kolektive, mund me pas përjashtime aty, por konsideroj pa e shiqu hiq 90% janë paga të mësuesve, paga jubilarë 3 paga të fundit etj. E kemi përsëritë 7-8 here, saher kanë qenë pasqyrat financiare, keni pasë shumë punëtorë me kontratë, nuk i ki, unë asaj konsideroj ka qenë një prej viteve më të mira që atyre të cilët nuk po kemi mundësi me ju kriju vende të reja të punës, bile me shti në konkurim të barabartë, me ja kriju përvojën e punës, edhe pse sivjet është shumë minimal. Konsideroj se vetem i kemi lëshu atyre në bujqësi për mos me shpu me kërkesë të drejtorit, mos me hup shancin fermerët me zanë afatin, por megjithatë asapekti ligjor po thotë mos lëshoni me kontratë. Unë konsideroj që edhe ata kanë pas nga një referat, e kanë bërë nga një përvojë dhe ligji po thotë me i pas, por ku e bënë përvojën ai në rast se nuk është kështu. A ligji aty po thotë me i pas 2 vjet përvojë pune nuk po e lenë as me konkuru. Ashtu janë këto ligjet tona, nuk është ligji i imi as i joti, është i të gjithëve, i konsiderohet përvojë pune. I nderuari shef i grupit, Jakup, krejt respektin thu a është shkelje e ligjit, mosperfillja e këshillave të fshatit të cilët japin prioritete kryetarit të komunës, po konsideroj që nuk është shkelje kurrë. Po ta përseris edhe një here, asnjë propozim, kryeministri i Kosovës ka të drejtë mos me ndegju atë të opozites rreth programit qeverisës të vetit 4 vite, se atë ja kanë besu qytetarët, por e thirrin gjithëhere për mos realizim të programit të vetë. Këtë e din edhe ti edhe unë, e njëjta vlenë edhe për kryetarin barometer. Në përfundim të mandatit, ki ndonjë organizatë që vjen kryetarit i thotë, nuk e ke përmbush propozimin e grupit parlamentar të LDK-së, këshilltarëve. Kurr nuk e pyet, kryetar, 23 premtime i ke pas, kaq i ke realizu plotësisht, kaq nuk i ke realizu, ajo është barometer matës. Këtë e din edhe ti, se ke përvojë, kjo është e verteta. Tjetra që është me rëndësi, projektet sivjet keni këmbngul, edhe kryesuesi ka qenë këmbngules, e kemi përfill, edhe ju mi emertu edhe projektet, edhe shumicën i kemi emërtu dhe kanë kalu në këtë Kuvend. Rrugës me zhavorr 100 metra, 200, nuk mundesh me emërtu, se të vynë procedurë e prokurimit, të cilët 6 vite me t'i lanë në administratë nuk mundesh me i qitë krejt. Ai që i ka keq përgjigjet për veprimet e veta procedurale, të cilat i ka bërë ligji në mënyrë kolektive, nuk e denon askëndë ligji, të denon për veprimet e tua individuale të cilat i ke bërë dhe qëndron mbrapa kësaj çështje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mundësisht ndëgjojmë mos të bëjmë debat pa e marrë fjalën, se edhe për procesverbal është problem, duhet të degjojmë përgjigjet për pyetjet që i kemi bërë. Unë një po themë, ekzekutivi është përgjegjës jo për premtime, jo për këshilla të fshatit, është përgjegjës për buxhetin që miratohet në Kuvend Komunal, për këtë e rrokë ligji. Projektë buxhetet çka miratohen në Kuvend Komunal duhet me respektu për çdo devijim të tij, është keqpërdorim. Për çështje tjera nuk i mban premtimet, akuzohet, këto janë çështje tjera. Ky buxhet i joni miratohet edhe në Parlament të Kosovës, bëhet zyrtar që ka me u respektu dhe me u bazu, dhe tasht rrugët rurale, asfaltimi, ato janë që plotësohen më vonë.

z.Besnik Ymeri, drejtor: Faleminderit për pyetjet! Pyetja e parë e profesorit Remzi, edhe i kisha dhanë përgjigje asamblistes Majlindes. Kodi përshembull, nderimi i rrugëve me zhavorr Beguncë, Lubishtë, Buzovik, Remnik, Pozheran, Radivojc, Smirë, Potgorc, ka mundësi që as në Lubishtë as në Remnik nuk është shtru asgjë, krejt këto 20 mijë euro. Kanë mujtë me shku veç në Pozheran, por kodi është ky, kodë për krejt ato fshatra edhe munden me u ndërtu vetem dikun me perfundu 20 mijë euro punë. Vetem me një fshatë paguhet prej këtij kodi, se këto janë të grumbullume në këtë kod, këto fshatra. Për zhavorr janë 3 kode të grumbulluara fshatarat e Komunës së Vitisë, cilat kanë me u shtru zhavorr, janë të grumbullume në 3 kode dhe mundet me punu vetëm me një fshat një sasi e caktume, por paguhet prej komplet kodit.

z.Jakup Demiri: Pikërisht është kjo që kur po bëhet buxheti që po thua, nuk dalin projektet të cilat kanë me u bërë përshebull kaq mjete, 400 e diçka mijë euro kanë qenë për zhavorr.

z.Besnik Ymeri, drejtor: Në kontratë e cila lidhet me Njësinë e Prokurimit është lista e të gjitha rrugëve që kompania është e obligume t'i zbatoj.

z.Jakup Demiri: Në këto nuk i kemi pas kur e kemi votu buxhetin, pikërisht njëra ka qenë kjo, për shkak që mos me i nda vetëm si shuma investimet kapitale dhe tash zhavorr i ke pas ndriçim dhe nuk i ke të përcaktume ku veç si shumë e kemi pas edhe për dy vitet e ardhshme.

z.Besnik Ymeri, drejtor: Vitin e kaluar i kemi pas 13 projekte, sivjet i kemi 45 projekte nëse nuk gaboj.

z.Jakup Demiri: Tjetra, është mirë me specifiku se janë pare, shembull, se jo mem dal mua Remniku në këtë rastë se nuk është punu.

z.Besnik Ymeri, drejtor: Nëse shkojmë ashtu si tha nënkryetari 5 milion euro, nuk mundemi me i hargju për 5 vite. Edhe nëse bëhet 100 metra një rrugë, procedurat i ka sikur për 100 kilometra. Këtë e din më mirë. Ti jap përgjigjet që mi keni bërë pyetje. Për ato të cilat nuk mundem të ju përgjigjem jua kthej me e-mail ose në seancen e ardhshme, ndërsa për kode i keni të gjitha në e-mail, ndërsa për kode ja u kam dërgu, por pa marr parasysh prapë po i lexoj 13/460 shërbime kontraktuese tjera, asgjesimi i mbeturinave në shëndetësi, bashkëfinancimi me Karitas Kosova, hartimi i planit komunal për energji, kodi 14/020, mirëmbajtja e ndërtesave. Pyetja ke, pse shuma e njëjtë, pse është kontratë. Përgjigjen mundet me dhanë drejtori Basri më në detaje. Kodi 13/430, shërbime të ndryshme shëndetësore, përkujdesi shtëpiak me Karitas Kosovën, pagesa për institutin publik, sigurimi i automjeteve është te pasqyrat financiare që i paraqet në detaje. Këto munden me dhënë më shumë detaje zyrat, pasi unë veç siguroj për vërtetësinë e pasqyrave financiare. Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve, kjo është shuma, ndonëse doni më në detaje mundeni ta kërkon kartelen për çdo shpenzim dhe si çdo here Liridonë, asnjëhere nuk ke mbet pa përgjigje. Rritja e mallrave dhe shërbimeve, ju e dini që janë rritë kostot. Rritjen e të hyrave të tatimit të pronë është për arsye angazhimi i përmbaruesit, i cili ka ekzekutu disa landë, por e cila gjithashtu ka ndiku pozitivisht që të tjerët me ardh me bë marrëveshje për pagesën me këste ose kanë ardh e kanë pagu komplet shumën. Planifikimi për të hyrat në tatimin në pronë bëhet nga departamenti i tatimit në pronë në ministri dhe ne e pranojmë ashtu si na dërgojnë. Krahasimet ndërvite, nëse e keni krahasimin për 3-mujorin e 2022-së, çdo 3-mujor e keni krahasim me 1 vit mbrapa, pasqyra financiare është krahasimi me vitin paraprak, pasqyrat janë të publikume në web-faqe. Dreka zyrtare është bërë temë më shumë politike se e shpenzimeve. Disa faktura kanë qenë të vitit të kaluar, të cilat nuk kemi mbërri me i pagu edhe pse për këtë pjesë drejtoritë apo zyrat të cilat kanë programe në vete munden me dhanë më shumë detaje, por kjo është vlera.

z.Basri Aliu, drejtori: Edhe për drejtorin e shërbimeve publike pat lidhje me hargjimet. Nexhati sigurisht e din, por deshti veç me ma dhanë fjalën se, këtu shumë thjeshtë po thotë, kodi 14/32, mirëmbajtja e autorrugeve lokale. Po, është edhe pastrimi i borës, është edhe mbushja me zhavorr në disa vende ku ka nevojë edhe asflatimi, mbushja e vrimave ku paraqitet nevoja, edhe anësoret, por tash nuk kemi ende, kur të bëhet krasitja e barit.

z.Remzi Salihu: Unë e morra një përgjigje, edhe aq sa muj unë me kuptu e kuptova, por megjithatë nuk jam ekonomist, prandaj po kërkoj me spjegju. The drejtor është çështje kodit po pajtohem me atë por unë këtu nuk po shofë që po shkrun kurrfar kodi te ky prezantimi analitik megjithatë nuk ka qenë vështir me nënvizu së paku ose një nënfjali me shtu aty ky investim është bërë në këtë lokalitet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Besoj që drejtori e nxjerrë cila rrugë është në atë projektë në Remnik dhe e shef që a është shtruar vitin e kaluar apo është më i gjatë.

z.Besnik Ymeri, drejtor: Mundem me ta ofru raportin e inxhinierit për këtë pagesë, pasi situacioni është në detaje për punën që është kry.

znj.Majlinda Shabani: Nënkyetar, me gjithë respektin dhe konsideratën për sa i përket fjalës joadekuate, të themë të drejtën dashta me përdor një qasje tjetër, por për me tregu pak respekt edhe mirësjellje përdora këtë fjalë. Për sa i përket punëtorëve të cilët i keni angazhu me kontratë për shërbime të veçanta, mundemi me thanë që ato kanë qenë shpagimi i personave të caktuar të cilët janë pagu për elektoratin që e kanë bërë ndaj PDK-së. Për sa i përket ndëritim të rrugeve në fshatin Lubishtë, nënkryetar nuk e morra përgjigjen për cilat rrugë ke. Për fshatin Lubishtë është mirë me specifiku në moment që cekët këtë periudh të caktuar kohore, sepse e dimë që si komunë për sa i përket dokumentacioneve qëndrojmë shumë mirë, por kur e shohim gjendjen faktike nuk është ajo që qëndron. Mendoj që si komunë është mirë me qenë më specifike në moment që e cekum dhe jo me i përfshi në një kod buxhetor me thanë, jo po në qet rrugë është bërë investimi, në rrugën tjetër nuk është bërë investimi. Tjera herë me qenë më specifik, mandej ne me pas më të qartë dhe mos me marrë fjalën me u zgjat kaq shumë.

z.Besnik Ymeri, drejtor: Ky kod ka kalu në këtë Kuvend, kështu kanë kalu kodet buxhetore, kështu që besoj që e dinë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Veç t'ja plotësoj Majlindes, se tha janë shpagu njerëzit e PDK-së, nuk është ashtu Majlindë.

znj.Majlinda Shabani: Kërkoj falje që e kam cek PDK-në, se LDK-ja. Nejse, ato të dyat bashkëqeverisje, kërkoj falje.

znj.Liridona Bislimi: Me të vërtetë është shqetësuese ky presion politik që bëhet ndaj pushtetit në Viti, tu fillu prej ekzekutivit, por edhe përfaqësuesve të këshilltarëve komunal ndaj opozitës në moment kur ne fillojmë me bërë një qasje konstruktive, me bërë një diskutim raport për raport se çka jemi fitu këtu. I nderuar nënkryetar, nuk thashë absolut që paret janë të juaja, paret thashë janë të qytetarëve, këtë e thashë për shkak se kërkova sqarim jo personal, por sqarim të përgjithshëm. Paret janë të qytetarëve të Vitisë dhe ata kanë nevojë ta dinë se ku po shkojnë taksat e tyre. Të nderuar përfaqësues të nivelit komunal, nuk është në rregull me reagu prej juve sikur janë paret e juve. Po flasim për 37 mijë euro, plus nëse janë 37 euro sot për sot dikush të kërkon llogari sot 37 mos me ti kthy dikush. Ne po diskutojmë për një shumë të madhe. Edhe për fund faleminderit shumë që po tregoni se çfarë ushqime po porositni prej nivelit të Zyrës së Kryetarit, se për besë e kemi pas pak dilemë me ditë.

z.Illir Zuka: Nënkyetar, po lidhem për atë që the për kshilla të fshatrave. Është shumë e vërtetë se kryetari e ka një projekt 4 vjeçar dhe me atë që delë në zgjedhje dikush fiton dikush jo, por për atë që fiton e kam fjalën. Çka më pengon mua që bëhet presion si administrator. Tash po flasë të mahet dëgjimi buxhetor, pse?

Nënkyetari i komunës, z.Hasan Aliu: Unë fillimisht po iku Majlinda, ndoshta i ka arsyet e veta, megjithatë më tha nuk u përgjegja që ishte ndaj Remziut që i thashë me hekë në rast se në Remnik nuk është shtru asnjë kaci, që është një realitet. Edhe në Lubishtë unë konsideroj që ishte përgjigje, se tema ishte e njëjtë. Liridonë, kur thua thirr me emer nënkryetar janë paret të qytetarëve, nënkupton se unë nuk po e disha që nuk janë, dhe pikerisht ai reagimi im ishte, asnjë presion as politik as psiçik. Nuk jam idhtar i asaj me të bërë, megjithatë në rast se ti mendon se ne duhet të diskutojmë këtu 2 orë për kodin paga dhe meditje, unë konsideroj se tash po ta themë me sinqeritet, je shumë largë kompetencave të këshilltares së Kuvendit Komunal. Pagat dhe meditje janë kategori të cilat vinë për të punësuarit dhe për të zgjedhurit, prandaj cila është arsya unë me hupë kohë në atë drejtim kur ti e dinë sikur unë se e ke marrë rrogën 250, tash e ke bërë 500 e më shumë dhe tash ne me shku me diskutu rreth asaj çështje. Ajo ka qenë e nivelit qendror, i ka marrë, e ka bërë kategorizimin dhe asnjë presion nuk ta kam bërë, unë veç tu kam lutë si këshilltare e kuvendit komunal, hajde të veprojmë dhe të punojmë aty ku është ndikimi jonë dhe kem të drejtë me pru vendim, asgje tjetër. Unë besoj të falenderova për gabimet gjuhësore që i ke gjetë, thashë hajde ndihmona dhe unë tashtë të qitsha e lamë këtu. Kurrë nuk kam ndërhy pse po i bënë këto diferenca. Ki qefë me ditë edhe pse shumicën i dinë, por e drejtë e

jotja me i ngritë, se është kompetencë e këshilltarit, por në rastë se ti më drejtohesh unë po pyes, nënkryetar, këto janë pare të qytetarëve, të jep me nënkuptu se unë nuk po disha dhe ti po më tregon mua. Unë këtë e di shumë mirë, vjetët ma kan përcatu me ditë paka para teje, jo që jam më i menqur, por vitet dhe jam shumë i përgjegjshëm ndaj kësaj. Mos me qenë shumë i përgjegjshëm nuk kisha qëndru qaq gjatë njeri. Më frikacak sa i përket çështjes së parasë publike se unë është problem me gjetë, por megjithatë detyrën të cilën më besohet duhet me kry deri në fund dhe ndaj kësaj asnjë presion kurrë. Tash po ta themë tu të respektu si këshilltare e Kuvendit Komunal në rast se ki durimin. Qe 1 muaj bëjë luftë me punëtorët e mi të cilët kemi pakjartësi rreth ligjeve pozitive në Republikën e Kosovës, a duhet auditori i brendshëm ta bëjë një raport në Kuvend apo nuk duhet. Rreth kësaj çështje i kam hupë 10-15 orë, mendime profesionale. Ata e mbrojnë se, Ligji mbi Auditimin thotë që, nuk duhet, unë thamë në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale se duhet, të obligon, dhe kemi mbetë këtu të cilët janë ka punojnë. Por, megjithatë, jemi në dilem se edhe unë i frikoj vetit se, nuk dua të bëjë presion me pru dikush një raport në rastë se unë e shkeli ligjin, tu e bë atë presion. Asnjë këshilltarë që ngritë një çështje, nuk e minimizoj, mundohem me krejtë potencialin që e kam, intelektual dhe profesional, me ardhë deri te përfundimi i asaj pyetje, sepse jeni të zgjedhur sikur është i zgjedhur edhe kryetari i Komunës. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ju kisha kërku që me qenë të përgjegjshëm, sepse nuk e dimi ligji si është për çështje të ndalesave të seancave, nuk kisha pas qef me mungu dikush, 1 orë keni pauzë. Pas pauzes shihemi prapë në seancë.

Mirë se erdhët në seancë pas pauzës. Kemi kalu pikën e dytë, pasqyrat financiare, ajo është veq informatë, nuk votohet në Kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë

z.Basri Aliu,drejtori: Faleminderit kryesues! Kjo draftë rregullore ka kalu në shqyrtim publik dhe përmes KPF-së unë në pika të shkurta do të mundohem që ta jap një pasqyrë rreth kësaj draft rregullore. Kjo rregullore përbëhet prej 11 kapitujve. Kapitulli 1 është dispozita e përgjithshme; kapitulli 2, sistemi për menaxhimin e mbeturinave; kapitulli 3, plani komunal për menaxhimin e mbeturinave; kapitulli 4, keni detyrat dhe përgjegjësitë e menaxhimit të mbeturinave; 5, aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave; 6, operatori për menaxhimin e mbeturinave; 7, kategorizimi i konsumatorit dhe tarifat për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave; 8, informimi, promovimi dhe raportimi i menaxhimit të mbeturinave; 9, bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave, 10, mbikëqyrja inspektive dhe kundërvajtje; 11, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Materialin e keni marrë me kohë, keni pas hapësirë me shfletu më në detaje, mi pa sqarimet për secilin kapitull veç e veç. Njëherit kjo dreftë rregullore pothuajse është unik për mbarë Kosovën. Është bërë një bashkëpunim me organizatën e GIZ-it, kështu që tash mbetet në domenin e juaj që të kalon përmes kuvendit dhe me voten e juaj të aprovohet apo të jepen vërejtjet aty ku është e nevojshme. Unë përveç kësaj e kemi edhe një plotësim ndryshim, sepse gjatë procesit kemi parë disa gabime që janë lëshu, kështu që para juve pi paraqes edhe ndryshimet të cilat janë bërë në këtë rregullore. Plotësim ndryshimi i propozimit të rregullores për menaxhimin e mbeturinave të Komunës së Vitisë: nën 1. të riformulohet neni 3, përkufizim paragrafi 1.37 të propozim rregullorës nga sektori njësi në zyrtarë përkatës të menaxhimit të mbeturinave, që vepron në kuader të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente, e cila zbaton politika në fushën e mbrojtjes së përcaktuar nga ministria përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi për krijimin e një sistemi të qëndrueshem për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe formulon shkresat nga SM në ZMM. Të gjithë rregulloret, për shkak të gabimeve teknike, këtu ka qenë për zyrtarin e menaxhimit të mbeturinave, ndërsa në draftë rregullore ka qenë sektori i menaxhimit të mbeturinave. Pasi që komuna jonë nuk ka mundësi ta bëjë

një sektorë të veçantë për menagjimin e mbeturinave, të kalohet në mundësinë e zyrtarëve për menagjimin e mbeturinave. Ky është ndryshimi. Ndërsa nën 2 e kemi të riformulohet neni 24 paragrafi 2 të rregullores së propozuar, Kuvendi me vendim cakton nënkategoritë e konsumatorëve dhe tarifave për menaxhimin e mbeturinave dhe nën 3 e keni pika 2 e nenit 36, propozim rregullores. Nën 4 të riformulohet teksti i nenit 38, të shihet teksti përmes kryetarit të komunës. Këto janë ato ndryshimet. Tash e keni mundësinë të debatojmë. Që keni ndonjë pyetje, do të ju përgjigjem qka të kem mundësi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo rregullore siç e shohim një prej pikave kryesore është që parashef edhe gjatë vitit me dhanë një raport që nuk ka qenë më herët, kjo është që e përgëzoj dhe duhet të ju përmbahemi kësaj që të jetë një pikë e veçantë gjatë vitit edhe në seancë për çështjen e mbeturinave, dhe raporti që do të lidhet përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe kompanisë që e kryen punën. Ndërsa te pjesa neni 24, Kuvendi cakton kategoritë. Kjo është edhe me ligj dhe tarifat për mbeturina. Te çështja e tarifave, do të jetë pjesë tjetër e rregullores që do të vij. Në të ardhmen e kemi diskutu, mirëpo duhet të harmonizohemi, sepse ne e dimë që para 2 muaje kanë hy në fuqi tarifat e reja dhe duhet të harmonizohemi që të jetë nivel regjional tarifat e njëjta, se nuk kemi mundësi të shkojmë ndryshe. Faleminderit drejtor, hapi diskutimin, nëse ka dikush për diskutim.

z.Musli Neziri: Meqense kemi marrë materialin me kohë dhe jam mundu me shiku mirë rreth rregullores, tek neni 5, pika 1.1 thotë se mbulohet i tërë territori i Komunës së Vitisë për grumbullimin e mbeturinave. Pyetja është drejtor, se sa deri tash është mbulu territori i Komunës së Vitisë për mbledhjen e menaxhimin e mbeturinave. Domethanë, a janë përfshi të gjitha lokalitetet, a ku qëndron përqindja. Neni 7 fletë për trajtimin e barabartë për të gjithë konsumatorët, se duhet të sigurohet që të ketë shërbim të kryer nga operatori. Të gjithë, ne jemi dëshmitar i asaj që, kompania në fjalë vjen nëpër lokacione të ndryshme dhe nuk i bënë mbulueshmërinë e tërë lokaliteteve. Neni 9 thotë: “plani komunal për menaxhimin e mbeturinave (***)”, 5 vjeçar dhe miratohet nga Kuvendi Komunal, ndërsa neni 13 thotë: “kur (nuk ndegjohet)”. ZMM që po flasim thotë propozon tarifen për menagjimin e mbeturinave dhe mënyrën e arkëtimit. Pastaj neni 13 dhe 24, 25 mua po më duket që po binë ndesh këto. Pse! sepse neni 24, pika 2 thotë: “Kuvendi i cakton nënkategoritë dhe tarifat”. Këtu e kemi te neni 13, ku fletë për detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit për menaxhimin e mbeturinave. Pika 1.5 thotë: “ZMM propozon tarifen për menagjimin e mbeturinave”. Neni 24, pika 2 thotë: “kuvendi i cakton nënkateogirtë e konsumatorëve dhe tarifat për menaxhimin e mbeturinave”. Tash cilit po i jetë detyra, neni 25, pika 3 fletë për faturimin e mbeturinave që ajo do të vie, do të diskutohet edhe njëhere se, ne nuk pamë askund çmim. Ne e dimë që para 2 muajve kryesuesi e ceku, është bë njëfar propozimi, kryesuesi ka pas takim me zyrratët e kompanisë në fjalë, që mos me pas ngritje. Pastaj tjetra, te neni 28, 29, flasim për informim dhe promovim. Mendoj që këtu në këtë rast, Drejtorisë së Shërbimeve Publike duhet të jetë një informim ose të insistohet me të vërtetë të punohet në këtë drejtim, që me bindë çdo qytetar që me hy në sistemin e menaxhimit të mbeturinave ose me një formë me detyru. Përshembull neni 34 fletë për mbiqyrjen dhe kundërvajtjen. Unë jam që edhe këtu me pas kujdes. Përshembull inspektorët komunal me dalë në teren. Nëse një lokalitet i caktum hynë 50% janë në sistemin e mbeturinave, ndërsa 50% e atij lokaliteti nuk janë. Rezultati është 0 nga aspekti i ndotjes së ambientit, sepse nuk kemi bë sistem të mirëfilltë, për arsye se një pjesë i hudhin mbeturinat që i merr kompania në fjalë, pjesa tjetër, ata prapë hudhin në natyrë dhe ndotja është e njëjtë, prandaj mendoj që këtu duhet me pas një kujdes më të shtuar, njëhere vetdijësimin dhe njëkohësisht me pas pjesen përbërëse ndëshkimin. Unë e pash që parashihet me ligj kundërvajtja ose hudhja e personit të panjohur. Komuna e ka përgjegjësinë me i hjek ato mbeturina. Ne po e shohim se, gjatë tërë muajit prill jeni marr. Për këtë punë nuk ka lanë drejtoreshë, për shkak të kushteve atmosferike, por edhe po është e kushtueshme për komunën, normalisht, sepse ato janë mjete të qytetarëve po edhe nuk po mundet me arritë që çdo dikaster ta pastroj. Ne e dimë, prandaj kërkoj që aty ku është e mundur që është mbulueshmëria e tërë

aty edhe me pas kujdes te përgjegjësi. Nëse një lokalitet ose nxjerret një modalitet se si me mujtë mi shti mi përfshi të gjithë mi ba një, informim të mirëfilltë dhe me i detyru tek e fundit që me hi në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Ne po flasim, sepse jemi të gjitha lokalitetet, një pjesë jemi, një pjesë nuk janë dhe kurrnifarë përgjegjësie s'ka, ai i hudhë mbeturinat ku të mun. Po flas, sepse nëse dilni që qatë deponinë mes dy fshatrave Ballacë, Tërpezë, rrugë që është aty, kemi çdo ditë që hudhin. Nuk po i fajsoj unë që vinë lokalitete tjera, po as unë kur do që më pyetni sun e di kush o tu e qitë rreth rrugës. Kemi pas raste kur jemi organizu, i pamë edhe në Kabash, janë organizu domethanë, vetë jam kanë pjesë që i kam pri m'i organizu, m'i hekë, prapë brenda 6-muajve është bënë njëjta gjendje, prandaj po du që mi kqyrë me bënë një regjistër, sepse nuk janë përfshi krejtë, cilido lokalitet dhe me tentu mi shti edhe ata, sepse nëse përfshihen të gjithë, atëhere është gjithçka në rregull. Besoj që ndikon në pastertinë e natyrës. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te çështja e rregullores, mu kyqë te pjesa tjetër që kjo e paraqet edhe raportin që kemi parapa, brenda vitit që me ardhë me bisedu vetëm për këtë çështje, ndërsa në rregullore duhet me i përfshi këto çështje se si do të përfshihem, si të bëhet mobilizimi dhe edhe një prej problemeve kryesore që është edhe caktimi i deponive, sepse nuk kemi caktim për deponi që besoj me planin urbanistik duhet të përcaktohen mirë, ku do të ketë mundësi edhe hudhja e mbeturinave inerte dhe këto tjera.

z.Sejdi Emini: Jemi në një temë mjaftë të ndejshme, ku tu e ditë që kompania është një partneritet publiko privat, që edhe i kufizon disa mundësi që nuk na jep krejt mundësitë me vepru, me mundësitë dhe kërksat reale, mirëpo megjithtë nuk amnistion prej përgjegjësi që i kemi si institucione dhe si Komunë. Problemi kryesor është në atë që u cek edhe më herët (nuk ndegjohet), problem kryesorë është se cila është mënyra dhe forma që kishim mujtë me u kyçë gjithë qytetarët që kanë mundësi ta bëjnë pagesen, përpos atyre që janë të lirum me ligj, derisa një pjesë e bëjnë pagesen dhe pastrohet nëpër pjesë ku veprojnë ata. Pjesa tjetër i hudh mbeturinat, nuk ka gjasë teorike për me mbërrit atë çka po kërkohet. Unë vij prej një lokaliteti ku fatkeqësisht ka mjaftë hapësira publike. Aty ku po ka hapësira publike, po gjejnë hapësira edhe për me i hudhë mbeturinat më shumë në vitin 2016 si fshat, mirëpo edhe me një organizatë që është ajo "Ta pastrojmë Kosovën", kemi qenë shembulli më i mirë në Kosovë, ku i kemi hjek të gjitha deponitë e egra prej fshatit pjesa nalt që edhe më heret u cekë, është një pjesë që mjaftë shfrytëzohet edhe për shëtitore. Me të vërtetë është tmerr dhe mjerim me ardhë me i kqyr mbeturinat e egra qysh janë hedhë. Ankesa ka pas edhe tek institucionet, këshilli dhe administratori i fshatit, mirëpo mbeturinat veç çka po vijnë aty tu rritë. Aty po hedhin më shumë bizneset që kanë kafeteri e restaurante, po pothuajse njëjtë është edhe një pjesë që kufizohet me Goshicë, pjesa e Verbanit. E pashë një vendim tek Plus Televizioni që ka marrë Komuna e Gjilanit, që deponitë e egra kishin marrë vendim mi hjek krejt. Unë kisha kërkë që edhe Komuna e Vitisë, pasi që është pranverë, natyra ka fillu me u gjelbru, sa më shpejt me u mobilizu dhe me u hjekë të gjitha deponitë e egra ku janë. Ashtu si janë nuk mjafton me mbajt vetëm pjesën e qendres ku rrinë një pjesë e qytetarëve. Qëllimin e mbërrim atëhere ku çdo skaj të territorit të Vitisë e bëjmë njëjtë, e pastrojmë njëjtë. Faleminderit!

z.Ramadan Deliu: Kryesues, ne po më duket jemi tu fol për një rregullore, jo ku ka mbeturina në Goshicë a në Kabash. E pashë një bërlllog aty, këtu. Ne jemi tu fol për këtë rregullore, e miratojmë këtë rregullore, mandej bisedohet për këto gjerat e tjera. Faleminderit!

z.Sejdi Emini: Unë mendoj që kërkesa që e pata edhe mënyrën që kërkova qysh me arritë me i futë të gjithë ata që kanë obligim me pagu, duhet me qenë pikërisht në kuader të rregullores. Edhe pasi nuk po na jepet mundësia, i kemi vetëm 2 pyetje në fillim të seancës jashtë rendit të ditës. Besoj që lidhen këto krejtë me këtë problematikë, e cila vazhdimisht na preokupon. Dani po insiston shumë me qenë mbrojtës i jo përgjegjësive të tij, e që gjithëhere kur po flitet po flitet në interes të qytetarit, kështu që mos të na bini në një pozitë me ja kthy me të njëjtën monedhë, se tana nuk i kursjemë as ne.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Sejdi! Nuk është puna kursimi, migjithatë unë kisha kërku me u lidh te rregullorja çka ka me u plotësu në rregullore që të bëhet më mirë, që mund ti shtimë këto çështje brenda rregullores, brenda nenit, ta plotësojmë nenin e caktum dhe t'i futim mundësitë për më mirë me funksionu çështja e menaxhimit të mbeturinave.

z.Ali Bajrami: Do të jem shumë i shkurtër. E falenderoj drejtorin për prezentimin e draft rregullores që e paraqiti para neve si këshilltarë komunal. Ajo çka më pëlqej që është rregullore, që është në diskutim publik, që e ka përfunduar diskutimin publik. Po është në koordinim me regjionin e Anamovës dhe është një përparësi që të gjejë harmonizim me të gjitha komunat, se pasi është shtrirja në krejt komunat e Anamoravës, besoj që do të ja dalim ta pastrojmë këtë ambient që pikërisht na shërben neve edhe ku jemi tu vepru edhe tu jetu. I spjegoj drejtorin edhe propozim ndryshimet që duhet të harmonizohen me ligj dhe me udhëzime administrative e përgëzoj për punën e bërë. Ajo çka e ceku edhe drejtorin që do t'i diskutojmë në seancat e radhës, do të ulemi do të bisedojmë, do t'i harmonizojmë të gjitha qëndrimet, e besoj që do të vimë me një përfundim që, kjo rregullore të jetë e pranushme edhe nga qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Ramadan Deliu: Kur tha Sejda ja kthejmë. Mua sun më kthen hiq, se nuk fola kurgja. Unë fola për miratimin e rregullores, se ne krejtë e dimë ku ka mbeturina, por duhet me u organizu krejt. Unë jam organizu në Kabash me drejtorin, i kemi hekë mbeturinat. Ne po folim për një rregullore, e miratojmë rregulloren e organizojmë krejtë.

z.Jakup Demiri: Këtë besoj që Dan edhe kjo puna e Sejdes, nuk e tha ndoshta decidivisht, por ka të bëjë që përime çka mundemi me shti ne në rregullore, që me i penalizu mundësinë e dikujt me hedhë mbeturina këdo. Me të vërtet se i tërë territori nga shkon ka mbeturina shumë dhe nuk kisha dashtë kështu të shohim me sy kritik njeri tjetrin. Mendoj se kishte me qenë mirë me i organizu disa debate, se po dal ndoshta jashtë rendit të ditës këtu, por megjithëse dokumenti si dokument është i mirë, tashti propozimi im është që në dokument me u parapa afate me datë, që në Smirë me mbajtë një dëgjim publik me qytetarët për vetëdijësim, me i inkuraju njerëzit që me hy në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, me bë pagesa dhe mos me hedhë mbeturina gjithka. Nuk po flas me emra, të gjithë në këtë jemi angazhu në vite të tëra, por e kemi pa që nuk mundesh me mri efektin. Kështu me majt ambientin e pastër, kushdo që ka ide për mua është i mirëseardhur me shti diçka në dokument. Unë kisha kërku që, kompania "Ekohigjiena" në Gilan e ka një bord. Me sa e di unë e kemi edhe ne Komuna e Vitisë një anëtar të bordit. Nuk po themë që me ardhë këtu në mënyrë detyruese diçka, por kisha pas qef me pas një takim me ta. Tash komuna nuk e di a takohet a nuk takohet, nuk është e thame që mu taku unë me të, por të ja lidhim krytë kësaj sa më mirë kësaj farë pune, se nuk është pak punë kjo nëse arrijmë ne me dhanë më të mirën e mundshme, me pastru ambientin tonë, besoj që kogjo për lakmi na kish kqyrë edhe kundërshtari më i madhë politik ose qysh do qoftë. Unë për vete pres ide prej kujdo çka i hynë në shërbim, se është një problematikë që po na përsëritet vite me radhë. Kot ne pastrojmë nëse nuk e mbërrimë punën e vetëdijësimit të qytetarëve. Edhe një here po ju themë, kisha kërku që në çdo fshatë të mbajmë nga një takim me banorët dhe të flasim për këtë problem. Po ju premtoj që, nëse jam këtu kisha me marrë pjesë në çdo takim kudo që e mbajnë. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Jakup! Megjithatë janë të paraqitura mirë edhe fushatat vetëdijësuse, domethanë që e përfshinë atë pjesën. Për këtë në rregullore janë të paraqit mirë disa gjëra.

z.Jakup Demiri: E kam lexu, por vetëm po dua të themë që, ne të shihet edhe te qytetari që është si kauzë e Qeverisjes Komonale, e Kuvendit Komunal dhe i të gjithave shtresave këtu që, kjo punë të merret me seriozisht, kjo problematikë edhe te qytetari jonë, besoj që ai që ka pak ndërdiqe nuk e hedhë më kur ta shef këtë angazhim.

z.Basri Sylejmani: Mirë e ka Jakupi, se unë e kryesoj këtë komisionin për shërbimet publike. Më së pari duhet mi vetëdijësu popullinë me shku me i kqyrë si e ka oborrinë e vet, edhe ai ne ta hudhë berllogun në

oborr të vet më së pari, mandej në ta hudhë edhe përjasht në vende publike. Ne kemi bisedu edhe me Halil Muslien, që është anëtar i bordit në Gjilan dhe Sejda ka qenë në komision, ne i kemi thanë si mu nda prej tyre, se ne pa u nda prej tyre nuk mundemi me ndërmarr asgjë. Ai krejt kompetencat po ti merr, ti nuk ke kompetenca për me egzekutu diçka, e për këtë po themë që, ne me mujtë mi shti, edhe popullata që është. Po foli edhe për Sodovinë. Në Sodovinë paguajnë 110 shtëpi, a janë 250-260 shtëpi. Atyre duhet me ju tregu njerëzve që, borgollu nuk duhet me u hedhë nëpër vende publike, por duhet me pagu edhe me ardhë kompania me marrë. Ne duhet popullin me vetëdijësu. Me i pa në Goshicë, Sodovinës së Muhagjerëve, edhe pampersat i gjujnë në rrugë. Besomni që, unë kam kap thes e kam largu prej rrugës, sidomos Sodovina e Muhagjerve e gjujnë krejtë bërlogun te zabelet e tona. Ai vet duhet me u vetëdijësu. A e qetë bërlogun në dhomë tane, e pse pe qetë në rrugë pra, por ne këto gjëra mes kuvendit duhet me ju tregu se, nuk bënë me gjujtë bërlog askund, por mbledhe te shtëpia më mirë është me djegë se me dalë me qitë në rrugë. Unë e di që atë e denon edhe me zanë e denon, por policia duhet me qenë numër 1 aktive, se policia e ndalon shqiptarin, si ta preksh në gjep ai meniher ndalet.

znj.Majlinda Shabani: Fillimisht po dua ta përshendes këtë draftë rregullore që është bërë për menaxhimin e mbeturinave, sepse me të vërtet është një problem shumë i madh jo vetëm në Komunën e Vitisë, por në krejt Kosovën. Këtu përfshihen shumë akter, që natyrisht edhe si komun nuk është që kemi shumë në dorë se çka mundemi me bë, po unë po du me i dhanë rekomandimet e mia, që kishin mujtë sadopak me ndiku që me arritë, që në fakt kjo draftë rregullore me u implementu. Se natyrisht që si material ose si pika, si nene janë shumë të mira, por po besoj që ndoshta kemi me pas parasysh edhe kompanin. Mandej në rast se ajo kompani nuk arrinë me i përmbush kërkesat e komunës sonë, me parapa mandej edhe rrugët e tjera, por po besoj edhe që është shumë e nevojshme që ne si komunë, përpos kompania që e ka për detyrë me bë edhe një analizë të gjendjes së tanishme që e kemi, një problem shumë i madhë është tek deponitë ilegale. Edhe një problem tjetër është që, nuk mundemi ne me detyru secilën shtëpi, secilën familje me u kyq, me bë pagesen për mbeturina. Unë kam pas diskutim me banorët e fshatit Lubishtë, me këshillin e fshatit, ku banorët kanë kërku që me bë obligative, që secila shtëpi me bë pagesën për mbeturina, por nuk është që kjo është e rregullume me ligj edhe po besoj që këtu e kemi një problem shumë të madh.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Nuk ka drejtori edhe çka përgjigjet. Ajo që më inkurajon në këtë draftë rregullore, që me përgëzu drejtorin me stafin e vetë së bashku me atë ekipen tjetër të GIZ-it edhe ekipet ndërkomunale, që gjithë po pajtohemi se emrusi i përbashkët, që mendim i përbashkët i këtij Kuvendi është se, gjendja sa i përket mbeturinave nuk është e nivelit të knaqshëm, dhe të gjithë po pajtohemi se, në këtë drejtim duhet me bë hapa, nuk duhet me qëndru këtu ku jemi. Format dhe mënyrat e gjetjes së atyre. Unë po shpresoj dhe besoj që pas miratimit të rregullores ne mund të bijmë edhe vendime të ndryshme, të cilat i rregullojmë me vendim. Një çështje aty sa na lejojnë edhe kompetencat. Unë kam qenë në takim kur është bërë ngritja e çmimeve, e kam kundërshtu, edhe pse nuk kam pas arsye, kam thanë, unë nuk i tham kryesuesit me qitë në Kuvend, se kjo nuk kalon, megjithatë pajtohemi krejtë që, nëse arrijmë 80% të ekonomive familjare me qenë pagues, unë besoj që çmimi automatikishtë bjen, duhet këtë me kuptu. Ajo çka e tha Jakupi që, plotësisht jam në organizim, gjetjen e një formule e cila do të jetë në organizimin e fushatës vetëdijësuse, të bëjmë një reklamë se, nuk ka ekonomi familjare që nuk po e pagujke rrymen elektrike. Pse nuk i barazpeshojmë, ajo e plotëson një nevojë, por edhe kjo e plotëson një nevojë tjetër, se me të vërtet si Viti dhe si Kosovë ne kemi një ambient të shkëlqyeshëm, ai do me mirëmbajtë. Isha në një vizitë para 3-4 viteve, kur u ktheva në mendjen time në zyre, po them se duhet me gjetë një formulë me dalë prej kësaj situatë, dhe mendimi im, po themë se gjithësecili qytetar i Republikës së Kosovës me thanë më nuk gjujë kurrë, por në ditë e heki nga një dhe e pastroj. Lënda mësimore e vetmja që e edukon prindin dhe e edukon gjithkënd është fëmija, por këtë ne nuk mundemi me bë, për shkak se jemi nivel komunal. Ne jemi keq me prerje të pyllit, por

kemi një shpresë që prapë rritet, por këto që jemi duke i bërë të kësaj natyre të bukur nuk na fal askush, andaj masat duhet të merren. Unë mund ta sjellë Senad Ramën që e përfaqëson, por ne mund të bijmë keq, sepse nuk i kemi mirë gjendjen nëpër lokalitete të kyqjes së shtëpive. Nëpër disa lagje kompania nuk shkon, sepse janë 40 shtëpi dhe paguan vetem 1 aty. Nuk i mbulon shpenzimet e kompanisë, dhe ne aty nuk mund të ndërhyjmë. Rregullorja është e shkëlqyeshme, por duhet të ketë zbatueshmëri.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Puna e drejtorisë është që e ka përgatit këtë rregullore, kurse puna e kuvendit është me diskutu dhe me bë më të mirë, dhe puna sa më e mirë e obligon ekzekutivin dhe pjesën tjetër për me zbatu këtë. Kuvendi e bënë rregulloren, ekzekutivi ka me zbatu dhe temat tjera do të bëjmë pika tjera se si me gjetë formë, se përderisa nuk i krijojmë çdo familjes që të ju kryhet shërbimi i marrjes së mbeturinave, ne nuk kemi bërë zgjidhje, sepse ai do ti hedhë dikund. Drejtorja e Inspeksionit përderisa nuk i dënon ren, nuk kemi me pas sukses. Me një vendim qeveria na ka ndalu duhanin krejtë venin, njëjtë duhet me vepru edhe këtu, se nëse e merr një dënim më shumë sa që paguan tërë vitin, ai kurrë më nuk ka me hedhë bërlllog askund.

z.Basri Aliu, drejtori: Me gjithë shqetësimet e asamblisteve, pajtohem, sepse me të vërtet gjenjda është ashtu edhe pse aty ku po intervenojmë po i largojmë mbeturinat, prapë po na u bëhen, edhe pse shpesh me drejtorin e inspeksionit kemi marrë aksione, kemi dalë në vend të ngjarjes kemi hallakat edhe mbeturinat për me gjetë ndonjë dokument apo diçka në mënyrë që sadopak t'i eliminojmë këto mbeturina. Sa i përket mbulueshmërisë, ajo është pothuajse në tërë territorin e Vitisë, përveç se në Dobëllde sa janë të kyqur familjet, ajo është pak diskutabile, sepse dikun sipas "Ekohigjenes" i kemi afër 60%, pjesa tjetër janë të pakyqur. Vetëdijësimin. Ne shpeshë edhe si komunë i kemi bërë disa aksione që sadopak janë fushat vetëdijësuse të pastrimit, e këto, por ato janë të pakta, por pajtohem që duhet me dalë çdo kund aty ku kemi hapësirë me ndiku secili prej nesh, në mënyrë që një familje me eliminu. Në këtë kuptim është sukses. Unë ju kisha lutë të gjithëve aty ku jeni, që të bisedoni, sepse ne jemi tu e mbrojtë natyrën tonë. Edhe më heret thashë që, iniciativa më ka pëlqy e "Lagjes Deliu", që ka qenë ndër iniciatorët edhe Ramadani, edhe një kompani tjetër na ka ndihmu, edhe e kemi eliminu. Po ajo duhet me u mirëmbajt që mos me leju që prapë të hedhen aty.

z.Musli Neziri: Faleminderit drejtor! Unë po dua të ndërlihem me këtë pjesën te vetëdijësimi dhe te detyrimi, se kryetari e ceku që me i dënu renë. Përshembull ne po flasim prej praktikave, komuna x fshatin e bënë shtrirjen e rrjetit të kanalizmit. Ne e dimë që ajo ndikon numër 1 në pastërti dhe qytetarëve të pandërgjegjshëm i shkon fal kanalizmi. Ai nuk kyqet, prandaj aty duhet të përcjellat që të detyrohet, sepse kemi raste të tilla që është bërë shtrirja e rrjetit të kanalizmit, që për një gyp ndoshta 2 metra ai prapë e ndotë natyrën, andaj ata duhet me i detyru ose me i dënu të bëhet një kontroll shumë e thjeshë. Mundet me u bë kjo të kyqen për arsye se, ne e dimë si popull ku jemi. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kisha kërkun me ngritje të dorës kush është që të miratohet kjo rregullore. Pra, me 18 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndekomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të mbeturinave

z.Basri Aliu, drejtori: Kryesues, edhe kjo ka ndërlihdje pak a shumë me këtë rregullore, sepse kryetarët e komunave të regjionit në bashkëpunim me GIZ-in i cili ka qenë iniciatori i kësaj, kanë nënshkru një marrëveshje për bashkëpunim për menaxhimin e mbeturinave rajonale, por kjo duhet të kaloj edhe përmes Kuvendit, në mënyrë që ajo të bëhet edhe plani i përbashkët i menaxhimit të mbeturinave rajonale.

z.Musli Neziri: Te kjo pjesa e komunave ku i përfshinë 2.7, komuna e Shtimes, është një gabim teknik, por e hupka kuptimin krejt.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. A jeni që të miratohet ky vendim pa Parteshin dhe me përmirësimin që tha Muslia? Pra, nga të gjithë të pranishmit, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e pestë e rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain Gjermani

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Shumica e këshilltarëve kanë qenë trend të kësaj, se ne kishim një marrëveshje bashkëpunimi të aprovuar edhe në Kuvend me Komunën e Kirchhain, Gjermanisë, por megjithatë më vonë ka lind idea edhe për binjakëzim. Ju e dini se në Strategjinë 2020-2030 është edhe komuna e Vitisë dhe me arritë një bashkëpunim jashtë sikur është strategjia dhe projekte të tjera të natyrave të ndryshme, duhet me pas një partner, një komunë e cila është në Bashkimin Europina. Për fat të mirë ne kemi edhe me Velika Pasanicen, por e kemi tash edhe propozimin me Komunën e Kirchhain. Ata kanë qenë një projekt, e kanë realizu, edhe pse ndoshta nuk i kemi mirëmbajtë boll atë projekt, destinimi për çka është bërë ka qenë një projektë mbjelljen e drunjeve dekorativ në rrrugën e Smirës, por megjithatë ka shenja që ato ekzistojnë edhe konsideroj se një binjakëzim i Komunës së Vitisë me një Komunë të Gjermanisë i bënë nder Komunës së Vitisë. Ata e kanë aprovu një çështje të tillë, por megjithatë kemi pas ndoshta probleme së bashku me Fatlumin. Ata kanë një model tej tër të funksionimit të kuvendeve komunale dhe diku 1 muaj e tepër na kanë hupë kohë tu i thanë dërgonaj atë dokumentë të cilin e keni miratu dhe të njëjtin ta përkthejmë dhe ta shtrojmë në Kuvendin Komunal të Vitisë. Megjithatë ata e kishin shumë të thjeshtë, numri i këshilltarëve kaq prej tyre kaq kanë votu për një ka abstenu dhe prandaj dikur thanë përgaditne ju pjesën e marrëveshjes. E kemi përgatit, ne e kemi përkthi në gjuhen gjermane, kryetari ka qenë atje dhe së bashku me kryeatrin e komunës e ka nënshkru, por megjithatë rendi dhe ligji i Kosovës e donë që të shtrohet në Kuvend.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materialin e keni marrë, nëse keni diçka për me diskutu, atëhere urdhëroni. Pasi që nuk ka për diskutim, kërkoj me ngritje të dorës të votohet. Pra, me 18 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vitisë

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Meqenëse zyrtari për riintegrim, Sami Demelezi nuk është këtu, është në një trajnim, drejtoresha Merrushe bënë prezantimin.

znj.Merrushe Ahmeti, drejtoresha: Faleminderit kryesues! Me leje të Samiut po ju informojë që, në lidhje me këtë plan kam qenë pjesë vet personalisht pjesë e trajnimit 3 ditorë, edhe është një plan i hartuar me shumë kujdes, ku kanë qenë pjesëmarrës shumë profesionist të fushave të ndryshme, kështu që është i përbër prej detajeve shumë të vogla, mirëpo që janë të rëndësishme në procesin e riintegrimin të këtyre kategorive. Po ashtu një çështje që ndoshta vlenë me u citu, që hartimi, zbatimi i këtij plani do të bëhet nga ministria. Pra, nga aspekti financiar nuk është diçka që varet prej komunës, mirëpo do të bëhet direkt prej ministrisë, kështu që neve na mbetet vetëm me pas si plan dhe me u përkujdes që me funksionu në mënyrën më të mirë të mundshme. Atëhere unë si drejtoresh, por edhe gjatë trajnimeve që kam qenë, ju rekomandoj që ta votoni këtë plan.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Edhe në KPF kemi diskutu me Saminë. Kësaj radhe ka hy edhe pjesa e të huajve riintegrimin të huajve, që nuk ka qenë në rregulloret e mëhershme, një rregullore që ka ardhë prej ministrisë, veç kanë pas me plotësu me specifikat që ka komuna, përndryshe është një rregullore unike prej

ministrisë. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, ju ftoj me ngritje të dorës që të miratohet kjo rregullore. Atëhere nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-110/05-108, të datës 01.02.2022 për plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-974, të datës 28.12.2021 për formimin e Komiteti për Komunitete

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne e dimë që kuvendi komunal i formon komitetet obligative. Komiteti për komitete, kemi pasurë një mungesë të një personi që ka qenë prej komitetit ashkali, kemi pas edhe kërkesën prej z.Reshatit, që të plotësohet ky komitet, dhe tash ju ka ardhë një propozim që, të zëvendësohet Ibrahim Berisha me Rifat Aniqi. Ky është propozimi. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka debat e qes në votim. Pra, nga të gjithë të pranishmit me votë për, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet.

Faleminderit shumë për kontributin, shihemi në seancat e radhës.

Mledhja përfundoj në ora 15:30

Procesmbajtesi
Fatlum Demiri

Kryesuesi I kuvednit Komunal
Bekim Azizi
